



Komisioni i Komunitetit Evropian, për llogari të dhe në emër të
Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në
Shqipëri

Komponenti B: Planifikimi i Zbatimit



18 nëntor 2008

Ky raport është përgatitur nga skuadra e projektit që punon për Grontmij I Carl Bro në kuadrin e nismës së financuar nga European Union CARDS 2006. Konstatimet, përfundimet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë ekskluzivisht ato të Grontmij I Carl Bro dhe në asnjë mënyrë nuk duhet menduar se pasqyrojnë mendimet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

PLANI I ZBATIMIT TË DIREKTIVËS SPECIFIKE

**Direktiva Kuadër për Ujin 2000/60/EC ashtu siç amendohet nga
Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktiva 2008/32/EC**

Autorët:

Paolo Bacca, Norman Sheridan, Jonathan Pearse

Falenderime:

Skuadra e projektit dëshiron t'i shprehë mirënjohjen e saj të gjithë personave dhe ekspertëve nga të gjitha institucionet dhe aktorët e përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe informacionit si edhe të gjithë personave dhe organeve të cilët mbështetën hartimin e këtij Raporti. I përcjellim falenderime të veçanta Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe të Administrimit të Ujërave si edhe stafit të ekspertëve të saj.

Pasqyra e lëndës

	Hyrje	5
1	Përmbledhje ekzekutive	6
2	Kërkesa e Legjislacionit të BE-së	10
2.1	Legjislacioni i BE-së i referuar	10
2.2	Kërkesat e Drejtpërdrejta të Legjislacionit	10
2.3	Kërkesat/Implikimet indirekte	14
2.4	Lidhjet me Legjislacionin tjetër	14
3	Gjendja aktuale	16
3.1	Politika e Qeverisë	16
3.2	Rolet & Përgjegjësitë	17
3.3	Kuadri Ligjor Aktual	20
3.4	Gjendja Aktuale e Zbatimit	24
3.5	Gjendja Aktuale e Investimeve	28
4	Plani i Përafrimit	31
4.1	Hyrje	31
4.2	Qasja për programin e veprimeve	31
4.3	Plani i Transpozimit	33
4.4	Plani i Zbatimit	34
5	Kostot dhe Përfitimet	43
5.1	Burimet dhe Kostot	43
5.2	Strategjia e Financimit	46
5.3	Përfitimet	49
	SHTOJCA I: Tabela e Përputhjes	51
	SHTOJCA II: Lista e Ndërhyrjeve me Kostot	77
	SHTOJCA III: Pasqyra e Kostove të Zbatimit	79

Lista e Shkurtimeve

AK	Autoriteti Kompetent
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PZDS	Plani i Zbatimit për Direktivën Specifike
KE	Komuniteti Evropian
AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
SSMNS	Strategjia e Sektorit Mjedisor dhe Ndërsektoriale
BE	Bashkimi Evropian
IRJM	Ish-Republika Jugosllave (e Maqedonisë)
SIGJ	Sistemet e Informacionit Gjeografik
SPG	Sistemi i Pozicionimit Global
PKNI	Parandalimi dhe Kontrolli i Ndotjes së Integruar
LBU	Ligji për Burimet Ujore (Nr. 8093 datë 21.3.1996 i ndryshuar)
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve
SKM	Strategjia Kombëtare Mjedisore
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujërave
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PNP	Parimi Ndotësi Pagan
ABL	Agjencitë e Baseneve të Lumenjve
KBL	Këshilli i Basenit të Lumenjve
RBL	Rrethi i Basenit të Lumenjve
PABL	Plani i Administrimit të Baseneve të Lumenjve
ARM	Agjencia Rajonale Mjedisore
QRM	Qendra Rajonale Mjedisore
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
AT	Asistenca Teknike
SAT	Skudra e Asistencës Teknike
TR	Termet e Referencës
ST	Sekretariati Teknik
UNU	Direktiva për Ujërat e Ndotura Urbane
DKU	Direktiva Kuadër për Ujin
ERSU	Enti Rregullator i Sektorit të Ujit

HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e vlerësimit ligjor, administrativ dhe institucional të gjendjes aktuale të përafrimit të “Direktivës që krijon Kuadrin për Veprimin Komunitar në Fushën e Politikës së Ujit 2000/60/EC” (shkurt Direktiva Kuadër për Ujin -DKU) ashtu siç amendohet nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktiva 2008/32/EC, si edhe planin e përgjithshëm për arritjen e përafrimit të plotë në kuadrin e përgatitjes për hyrjen e vendit në BE. Gjithashtu ky raport merr në shqyrtim edhe Direktivën 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe dëmtimi, e cila plotëson dispozitat e DKU-së përse i përket mbrojtjes së ujërave nëntokësore.

Raporti e vë theksin tek boshllëqet dhe problemet/pikat e dobëta të cilat mund të pengojnë transpozimin dhe zbatimin e efektshëm të Direktivës në fjalë dhe, prandaj, bën identifikimin e rritjes së kapaciteteve që nevojiten për të siguruar një zbatim sa më efikas dhe të efektshëm të saj. Raporti gjithashtu paraqet edhe përlogaritjet më të mira të kostove dhe përfitimeve që mund të realizohen për momentin.

Raporti mbështetet në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës në dispozicion, së bashku me kontaktet e shumta si edhe diskutimet e hollësishme të zhvilluara si brenda Skuadrës së Asistencës Teknike (SAT) ashtu edhe ndërmjet anëtarëve të SAT-it dhe një numri të madh të zyrtarëve kryesorë.

Raporti ndahet në pesë seksione kryesore. Në Seksionin 2 jepet një vështrim i përgjithshëm i shkurtër të Direktivës, dhe në Seksionin 3 bëhet një përmbledhje e situatës ekzistuese në Shqipëri përse i përket përafrimit të kësaj Direktive, ku përfshihet edhe një analizë e boshllëqeve ligjore. Në Seksionin 4 diskutohen mekanizmat e zbatimit dhe përcaktohen disa rekomandime për përfundimin e përafrimit të Direktivës. Në Seksionin 5 paraqitet një vlerësim tregues i kostove të zbatimit.

1 Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi dhe efekti që synohet nëpërmjet zbatimit të DKU-së

Objektivi kryesor i DKU-së është që të sigurohet arritja e një gjendje të mirë nga ana e trupave ujorë deri në vitin 2015.

Ky objektivi i përgjithshëm do të arrihet nëpërmjet veprimeve të ndërmarra në nivelin e çdo rrethi të baseneve të lumenjve sipas procesit të përshkruar në DKU. Në formën e tij më të thjeshtë, ky proces përfshin:

- Identifikimin e rretheve të baseneve të lumenjve si edhe identifikimin e trupave ujorë që rrezikojnë të mos gëzojnë një gjendje të mirë deri në vitin 2015, si edhe zhvillimin e një analize ekonomike të përdorimit të ujit të tyre.
- Krijimin e një regjistri të zonave të mbrojtura në çdo rreth të baseneve të lumenjve.
- Ngritjen e një skeme monitorimi.
- Hartimin e një plani për administrimin e baseneve të lumenjve në konsultim me palët e interesuara si edhe zhvillimin e një programi për masat e kërkuara për arritjen e objektivave për trupat ujorë në rrethin e baseneve të lumenjve.
- Vënien në zbatim të masave.
- Arritjen e objektivave dhe rishikimin e masave.

Zbatimi i DKU-së do të ketë ndikim tek aktorët e interesuar në administrimin dhe përdorimin e ujit në Shqipëri: industria e ujit, autoritetet vendore, të gjitha bizneset të cilat kanë leje për shkarkimin e ujërave, leje për tregtimin e ujit, apo leje për nxjerrjen e tij autoritetet e lundrimit , si edhe mbi industrinë, bujqësinë dhe peshkimin më në përgjithësi.

Zbatimi i DKU-së do të sjellë përfitime në drejtim të cilësisë ekologjike të mjedisit ujor dhe kuadrit të politikave për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor. Përfitimet kryesore mund të përmbledhen si më poshtë:

- Një përmirësim në cilësinë e e ujit natyral si edhe një disponueshmëri më të madhe të burimeve ujore.
- Mbrojtja dhe shtimi i florës dhe faunës ujore. Direktiva ka si synim të sigurojë që organizmat ujorë vendas të tillë si bimët dhe peshqit mund të mbijetojnë dhe të riprodhohen. Kjo do të

mbështesë më tej kafshët dhe shpendët përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor.

- Përmirësimet fizike të disa habitateve ujore gjithashtu mund të kërkojnë atje ku është e nevojshme që biologjia vendase të mbijetojë dhe të shumohet. Këto përmirësime në mbrojtjen e habitateve dhe specieve gjithashtu do të rrisin edhe vlerën e kënaqësisë të rrjedhave të ujit.
- Ajo prezanton një përkufizim të ri të gjendjes së ujërave sipërfaqësore që ka të bëjë me shëndetin ekologjik të trupave ujorë si edhe të standarteve kimike. Ajo gjithashtu pasqyron ndërveprimet ndërmjet ujërave nëntokësore dhe atyre sipërfaqësore si edhe marrëdhënien ndërmjet elementeve fizike të tilla si struktura dhe shpejtësia e rrjedhës së ujit si edhe cilësinë e tyre kimike dhe biologjike.
- Ajo prezanton një kuadër më koherent të legjislacionit për ujin duke bashkuar të gjitha masat e nevojshme për administrimin e ujëmbledhësve të lumenjve dhe ujërave sipërfaqësore.
- Ajo prezanton një administrim më koherent të rretheve të baseneve të lumenjve, duke mundësuar zhvillimin e strategjive shumë më kosto efektive. Direktiva kërkon krijimin e një sistemi për administrimin e baseneve të lumenjve, me plane të bashkërenduara për administrimin e baseneve të lumenjve, duke pranuar ekzistencën e lidhjeve ndërmjet të gjitha ujërave në një rreth basenesh lumenjsh, ku përfshihen edhe ujërat nëntokësore si edhe ato bregdetare.
- Ajo lejon një planifikim më të mirë të masave për mbrojtjen e ujit. Analiza e një rrethi të tillë basenesh lumenjsh do të sigurojë informacion më të mirë, duke lejuar një planifikim dhe caktim më të mirë të masave që do të merren për ato zona ku përfitimet mjedisore janë mjaft të dukshme.
- Ajo siguron më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri. Direktiva në fjalë do të kërkojë transparencën e duhur gjatë procesit të planifikimit të administrimit të baseneve të lumenjve. Kjo do t'u sjellë përfitime si përdoruesve të ujit ashtu edhe Qeverisë apo autoriteteve kompetente.

Historiku

Ligji për Burimet Ujore (LBU) është legjislacioni kryesor për administrimin e burimeve ujore në Shqipëri; ai parashikon mbrojtjen, zhvillimin, përdorimin e qëndrueshëm dhe shpërndarjen e burimeve ujore, mbrojtjen nga ndotja etj. Ai gjithashtu krijon kuadrin institucional, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë të baseneve ujore, për zbatimin e politikës së burimeve ujore.

LBU-ja përcakton statusin ligjor të ujit dhe pronave ujore, veprimtaritë dhe organizimin e administrimit të ujërave, kushtet për përdorimin e ujit, mbrojtjen e ujit, zhvillimin, përdorimin e qëndrueshëm dhe shpërndarjen e burimeve ujore, mbrojtjen nga ndotja dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me administrimin e ujërave.

LBU-ja krijoi këshillin Kombëtar të Ujit (KKU) si organi përgjegjës për përcaktimin e politikës së ujit dhe për marrjen e vendimeve kryesore të lidhura me të, si edhe “agjencinë e tij ekzekutive”: Sekretariatit Teknik.

LBU-ja e ndan Shqipërinë, për qëllimet e administritimit të ujërave, në basene ujore dhe krijon Këshillat e Baseneve të Lumenjve (KBL) ashtu si edhe “autoritetet vendore përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse”. KBL-të varen nga Sekretariati Teknik i KKU-së. Përsa i përket veprimtarive të tyre, KBL-të lëshojnë: a) lejet e ujit për të përdorur sasi të specifikuar për një qëllim specifik për një kohë të caktuar, dhe b) koncesione, kryesisht për nxjerrjen e zhavorrit, në vijim të kërkimeve të bëra në bazë të autorizimit të dhënë nga KKU-ja.

Në përputhje me LBU-në , u hartuan dhe u miratuan në shtator të vitit 2003 Strategjitë e Sektorit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve për Shqipërinë.

Detyrat administrative që kanë të bëjnë me ujin, tradicionalisht janë ndarë ndërmjet:

- *Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave*, e cila merret me administrimin e ujërave ku përfshihen: lejet për shkarkimet e ujërave, mirëmbajtja e cilësisë së ujit, si edhe, nëpërmjet kontratave me Institutet Shkencore, monitorimin e ujit.
- *Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*, e cila është përgjegjëse për përdorimin e ujit për ujitje.
- *Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve*, e cila është përgjegjëse për problemet e ujësjellësave dhe kanalizimeve të ujërave të zeza.
- *Ministrisë së Shëndetësisë*, , e cila është përgjegjëse për vendosjen e standarteve për ujin e pijshëm si edhe monitorimin e cilësisë si të ujit të pijshëm ashtu edhe të ujërave banjatore.
- *Autoriteteve Vendore*, të cilat kanë përgjegjësinë për administrimin e ujësjellësave dhe grumbullimin e ujërave të ndotura, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

Problemi

Një nga kushtet kryesore për anëtarësimin në BE është integrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së, i ashtuquajtur i procesi i përafrimit. Transpozimi i kërkesave ligjore të DKU-së në legjislacionin kombëtar është hapi i parë i nevojshëm në drejtim të zbatimit me sukses të saj. Kjo kërkesë formale ende nuk është përmbushur në Shqipëri, për shkak të ekzistencës së disa boshllëqeve ligjore në LBU.

Sfidat e përgjithshme në zbatimin e dispozitave të DKU-së mund të përshkruhen si më poshtë:

- Sigurimi i financimit për masat që duhet të merren në bazë të direktivës;
- *Integrimi i aspekteve të ndryshme të administrimit të ujërave, identifikimi i sinergjive dhe mundësi i një menaxhimi efikas të burimeve ujore në nivel lokal;*
- Krijimi i një bashkëpunimi të efektshëm horizontal ndërmjet autoriteteve vendore me qëllim shpjegimin e qasjes së administrimit të integruar të baseneve të lumenjve, si edhe bashkëpunimi vertikal ndërmjet niveleve të ndryshme të administratës;
- Ngritja e sistemeve efikase të monitorimit për të lehtësuar zbatimin e efektshëm të direktivave;
- Sigurimi i kapacitetit të mjaftueshëm administrativ në nivel rajonal dhe lokal duke gjetur burimet financiare, informacionin dhe ekspertizën e duhur teknike;
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut si edhe transparenca e proceseve të politikave.

Plani i përafrimit

Është hartuar plani i përgjithshëm për arritjen e përafrimit të plotë. Ai përbëhet nga plani i transpozimit ligjor dhe nga plani i implementimit (ku përfshihet edhe zbatimi).

Plani i transpozimit ligjor përbëhet nga pesë veprime të cilat në fillim do të parashikojnë disa rregullime/amendime të LBU-të (ose përfshirjen e detyrimeve që mungojnë, ose riformulimin e dispozitave ekzistuese të cilat nuk janë plotësisht në përputhje me dispozitën e Direktivës përkatëse si edhe me dispozitat e qarta të bazës ligjore), po ashtu edhe hartimi i akteve nënligjore.

Plani i zbatimit përbëhet nga një numër veprimesh të cilat janë ndarë në katër grupe kryesore të veprimeve të implementimit.

Në Tabelën 1 më poshtë janë paraqitur elementet kryesore të planit të përgjithshëm për përafrimin e plotë (duke filluar nga viti 0- viti aktual i fillimit ende duhet të përcaktohet).

Tabela 1: Elementet kryesore të planit të përgjithshëm të përafrimit

Plani i përgjithshëm i përafrimit	Fillimi (muaji/viti)	Mbarimi (muaji/viti)
<i>Transpozimi ligjor</i>	01/0000	06/0003
<i>Implementimi dhe zbatimi</i>	07/0000	12/0004
• Forcimi institucional	07/0000	12/0002
• Përmirësimi i administrimit të baseneve të lumenjve	01/0001	12/0004
• Monitorimi dhe analiza e gjendjes së ujit	01/0001	12/0004
• Analiza ekonomike, programet planifikuese të masave për administrimin e baseneve të lumenjve, raportimi	01/0001	12/0003

Zbatimi i DKU-së do të shoqërohet me kosto si nga procesi i PABL-së ashtu edhe nga programet e masave të identifikuar gjatë këtij procesi, edhe pse pjesa më e madhe e kostove të masave do t'i atribuohen direktivave të tjera specifike, të tilla si Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane si edhe Direktiva për Nitratet, dhe jo DKU-së.

Kostot për transpozimin e plotë të Direktivës në legjislacionin kombëtar dhe për zbatimin e saj janë përlogaritur tashmë. Të gjitha kostot janë përlogaritur në bazë të çmimeve konstante të vitit 2008. Përsa i përket transpozimit, duke pasur parasysh burimet e kufizuara në hartimin e legjislacionit brenda MMPAU-së rekomandohet që skuadrës ligjore t'i sigurohet mbështetje e mëtejshme në përfundimin e këtij legjislacioni (përveç mbështetjes që do t'i jepet nëpërmjet projektit aktual). Kostoja e parashikuar e asistencës teknike që nevojitet për këtë qëllim do të jetë 800,000 Euro. Kostot e përlogaritura të zbatimit përbëhen nga kostot kapitale prej 5,4 milion Eurosh si edhe nga kostot periodike shoqëruese prej 524,000 Eurosh në vit. Rreth 88% e kostove kapitale të implementimit është llogaritur për asistencë teknike. Kostot e zbatimit do të mbështeten nga Autoriteti Kompetent si edhe nga autoritetet e reja të baseneve të lumenjve. Kostot totale kanë të bëjnë kryesisht me krijimin e infrastrukturës administrative dhe ndërtimit të kapacitetit të saj, dhe jo me kostot e masave teknike (të cilat supozohet se do të dalin gjatë Direktivave të tjera).

Është vlerësuar se një total prej 25 personash do të nevojitet me një kosto prej 290,400 Eurosh në vit (duke përfshirë edhe kostot që kanë të bëjnë me punësimin). Kostoja totale e përlogaritur për projektet e AT-së shkon në 4.8 million Euro. Kostot e tjera do të shërbejnë për përmirësimin e rrjetit monitorues si edhe për zhvillimin e programeve të nevojshme të monitorimit, duke siguruar dhe/ose përmirësuar harduerët dhe softuerët e bazës së të dhënave GIS(SIGJ), konsultimin me publikun i planeve të administrimit të baseneve të lumenjve si edhe për raportimin para Komisionit Evropian. Nevoja për burime njerëzore shtesë që nevojiten për përmbushjen e funksioneve të reja që përcaktohen nga DKU-ja dhe ligje të tjera evropiane, duhet të pajtohen me objektivat makroekonomike të Shqipërisë të cilat përfshijnë reduktimin e numrit total të vendeve të punës në sektorin publik si edhe uljen e deficitit të buxhetit të saj. Mendohet që kjo do të bëjë të mundur kompensimin e kostove të reja të punësimit të paktën pjesërisht duke rekrutuar personel të ri ndërmjet nëpunësve civilë ekzistues (pa i zëvendësuar ata) apo nëpërmjet shkurtimit të vendeve të punës në sektorin publik diku tjetër.

2 Kërkesa e Legjislacionit të BE-së

2.1 Legjislacioni i BE-së i referuar

Legjislacioni i BE-së i referuar në këtë plan zbatimi është:

- *Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës që krijon kuadrin për veprim komunitar në fushën e politikës së ujit, ashtu siç amendohet nga Vendimi 2455/2001/EC i Parlamentit dhe i Këshillit të Evropës që krijon listën e substancave prioritare në fushën e politikës së ujit, si edhe Direktiva 2008/32/EC e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës që amendon Direktivën 2000/60/EC e cila krijon kuadrin për veprim komunitar në fushën e politikës së ujit, përsa i përket kompetencave zbatuese që i jepen Komisionit.*
- *Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe dëmtimi.*

Direktiva 2006/60/EC përcakton kuadrin për administrimin e cilësisë së ujit brenda vendeve Anëtare – Direktiva Kuadër për Ujin (DKU). DKU-ja cakton parimet bazë për një politikë të qëndrueshme për ujin në Bashkimin Evropian përmes një strukture administrimi të integruar për politikën e ardhshme evropiane për ujin, duke u mbështetur tek një bashkëpunim më i ngushtë dhe veprime më koherente në nivel Komuniteti, Vendi Anëtar dhe atë lokal. DKU-ja kërkon një përfshirje më të madhe të publikut dhe një bashkëpunim të ngushtë me Vendet jo-Anëtare, si edhe asistencën e organizmave përkatës ndërkombëtare të mbrojtjes së ujit.

Direktiva e re për Ujërat Nëntokësore (2006/118/EC) përcakton marrjen e masave specifike, (siç parashikohet në DKU) me qëllim parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së ujërave nëntokësore. Direktiva në fjalë gjithashtu plotëson dispozitat e DKU-së në drejtim të parandalimit apo kufizimit të hedhjes së ndotësve në ujërat nëntokësore si edhe synon të parandalojë përkeqësimin e gjendjes së të gjithë trupave të ujërave nëntokësore. Kështu ajo mund të shihet si një pjesë përbërëse e zbatimit të Direktivës Kuadër për Ujin.

2.2 Kërkesat e Drejtpërdrejta të Legjislacionit

DKU-ja parashikon detyrimet e mëposhtme për Vendet Anëtare:

- Të krijojnë Autoritetet Kompetente, ose duke përdorur strukturat ekzistuese ose nëpërmjet krijimit të atyre të reja, si edhe të hartojnë programe administrative për të siguruar zbatimin me efektshmëri të direktivës në fjalë brenda Rretheve të Baseneve të Lumenjve (Neni 3(2)-(4));
- Të identifikojnë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në Direktivë, si edhe të përcaktojnë në drejtim të të gjitha ujërave përkatëse brenda territorit të Vendi Anëtar të gjitha kategoritë e kërkuara të ujërave, si edhe të evidentojnë më tej se cilat prej këtyre kategorive janë pjesë e rretheve ndërkombëtare të baseneve të lumenjve (Nenet 2 dhe 3, si edhe Shtojca II);
- Të identifikojnë basenet e lumenjve (dhe, sipas rastit edhe nën-basenet) dhe t'ia caktojnë ato rretheve individuale të baseneve të lumenjve. Dy ose më shumë basene lumenjsh mund të kombinohen në një rreth basenesh lumenjsh të vetëm, aty ku është e përshtatshme. (Neni 3(1)). Basenet e lumenjve të cilat mbulojnë territorin e më shumë se një Vendi Anëtar do t'i caktohen një rrethi ndërkombëtar basenesh lumenjsh. Jo më vonë se deri në datën 22 dhjetor 2003, duhet caktuar autoriteti kompetent për secilin prej rretheve të baseneve të lumenjve;
- T'ia caktojë të gjitha ujërat nëntokësore rrethit të basenit të lumenjve më të afërt apo përndryshe më të përshtatshmit prej tyre. (Neni 3(1));
- Të krijojnë një regjistër apo regjistra të të gjitha zonave që shtrihen brenda çdo rrethi basenesh lumenjsh të zbatueshëm për të cilët është përcaktuar se kërkojnë mbrojtje të veçantë në bazë të legjislacionit specifik të Komunitetit për mbrojtjen e ujërave të tyre sipërfaqësore apo nëntokësore apo për ruajtjen e habitateve dhe të specieve që varen drejtpërdrejtë nga uji (Neni 6(1)) që duhet të përshijnë të gjitha trupat ujorë të identifikuar sipas Neni 7(1) si edhe për të gjitha zonat e mbrojtura që mbulohen nga Shtojca IV (Neni 6(2)), dhe të parashikojnë që ato të rishikohen dhe të përditësohen (Neni 6(3));
- Të hartojnë programe për monitorimin e gjendjes së ujit me qëllim zhvillimin e një vështrimi të përgjithshëm koherent dhe gjithëpërfshirës të gjendjes së ujit në çdo rreth baseni lumenjsh (Neni 8(1) dhe Shtojca V, si edhe t'i vënë këto programe në zbatim të paktën gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të Direktivës (Neni 8(2));
- Të identifikojnë, në bazë të rezultateve të arritura nga programet e monitorimit, të zbatueshme për çdo trup ujor, statusin e tij ekologjik, kimik si edhe përcaktimet e zbatueshme për "gjendjen e ujërave sipërfaqësore" dhe "gjendjen e ujërave nëntokësore" (Neni 8 dhe Shtojca V);
- Jo më vonë se katër vjet pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj direktive, të zhvillojë analizën e karakteristikave të çdo rrethi baseni të lumenjve, një rishikim të ndikimit të veprimtarisë së njeriut mbi ujin, si edhe një analizë ekonomike të përdorimit të ujit

dhe të krijojë një regjistër të zonave që kërkojnë mbrojtje të veçantë. Duhet të identifikohen të gjithë trupat ujorë të përdorur për nxjerrjen e ujit të përdorur për konsum nga njeriu duke siguruar jo më shumë se 10 m³ në ditë mesatarisht ose duke iu shërbyer më shumë se 50 personave ;

- Nëntë vjet pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, duhet të hartohet një plan administrimi si edhe një program për masat e marra për çdo rreth baseni lumenjsh , duke marrë parasysh rezultatet e analizave dhe studimeve të kryera;
- Masat e parashikuara në planin e administrimit të baseneve të lumenjve synojnë të:
 - Parandalojnë dëmtimin, të shtojnë në numër dhe të rehabilitojnë të gjithë trupat e ujërave sipërfaqësore, të arrihet një gjendje e mirë kimike dhe ekologjike e ujërave të tilla si edhe të reduktojnë ndotjen e shkaktuar nga shkarkimet në ajër dhe ujë të substancave të rrezikshme;
 - Mbrojnë, shtojnë në numër dhe të rehabilitojnë të gjithë trupat e ujërave nëntokësore, të parandalojnë ndotjen dhe dëmtimin e ujërave nëntokësore, si edhe të sigurojnë një ekuilibër ndërmjet nxjerrjes dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore;
 - Të ruajnë zonat e mbrojtura.

Objektivat e lartpërmendura duhet të arrihen jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj direktive, por ky afat mund të zgjatet apo të shkurtohet, edhe pse në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë Direktivë;

- Të inkurajojnë përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në zbatimin e kësaj Direktive, në veçanti në drejtim të planeve të administrimit të baseneve të lumenjve (konsultimet me publikun);
- Të lejojnë dëmtimin e përkohshëm të trupave ujorë nëse kjo vjen si rezultat i rrethanave të jashtëzakonshme apo të cilat nuk mund të parashikoheshin dhe të cilat rrjedhin nga një aksident, shkak natyror apo forcë madhore;
- Deri në vitin 2010, të sigurojnë që politikat e caktimit të çmimeve të ujit të sigurojnë stimujt e mjaftueshëm për përdoruesit që ata t'i përdorin burimet ujore me efikasitet si edhe që sektorë të ndryshëm ekonomikë të kontribuojnë për rikuperimin e kostove të shërbimeve të ujit duke përfshirë edhe ato që janë të lidhura me mjedisin dhe burimet;
- Të përdorin listën e substancave prioritare të përzgjedhura ndërmjet atyre që paraqesin një rrezik të madh për mjedisin ujor apo nëpërmjet tij. Gjithashtu do të propozohen masat e duhura për kontrollin e këtyre substancave, si edhe standartet e cilësisë të zbatueshme për përqendrimit e tyre¹. Synimi i këtyre masave të marra është reduktimi, ndalimi apo eliminimi i shkarkimeve në ajër

¹ Shikoni qëndrimin e përbashkët (EC) Nr 3/2008 i miratuar nga Këshilli më 20 dhjetor 2007 me qëllimin për të miratuar Direktivën 2008/...EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës ... për standartet e cilësisë mjedisore në fushën e politikës së ujit si edhe Direktivat amenduese 82/176/EEC, 83/513/EEC, 84/156/EEC, 86/280/EEC dhe 2000/60/EC.

dhe ujë , si edhe i humbjeve të substancave prioritare. Kjo listë përbën Shtojcën X të kësaj Direktive;

- Të përcaktojnë penalitetet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave të miratuara të cilat duhet të jenë të efektshme, proporcionale dhe shkurajuese;
- Të synojnë të vënë në funksion një sistem monitorimi që t'i lejojnë atij të demonstrojë që është i aftë dhe që po i arrin objektivat e kësaj Direktive, duke përfshirë në veçanti ato të parashikuara në Nenet 4, 7, 16 dhe 17;
- Të krijojë sistemet e raportimit për t'i siguruar Komisionit një numër raportesh dhe informacionesh. Për shembull, një hartë apo disa harta (në formatin GIS) të vendndodhjes gjeografike të llojeve të trupave të ujërave sipërfaqësore në pajtim me shkallën e diferencimit që kërkohet në bazë të sistemit A (Shtojca II, 1.1(vi)) apo të kryejë analizat që kërkohen nga Neni 5 si edhe programet e monitorimit të përcaktuara në Nenin 8, të ndërmarra për planin e parë të administrimit të baseneve të lumenjve brenda tre muajve nga përfundimi i tyre (Neni 15(2)).

Shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të Direktivës (2007), legjislacioni i mëposhtëm duhet të shfuqizohet: Direktiva 75/440/EEC, Vendimi 77/795/EEC, dhe Direktiva 79/869/EEC. Trembëdhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të Direktivës (2013), legjislacioni i mëposhtëm duhet të shfuqizohet: Direktiva 78/659/EEC, Direktiva 79/923/EEC, Direktiva 80/68/EEC, dhe Direktiva 76/464/EEC me përjashtim të Nenit 6, i cili u shfuqizua me hyrjen në fuqi të kësaj Direktive.

Kërkesat kryesore të drejtpërdrejta të lartpërmendura mund të grupohen sipas funksioneve të mëposhtme të administrimit mjedisor:

Zhvillimi i politikës së ujit

Zhvillimi i një politike të integruar të Komunitetit, në lidhje me dhe për përdorimin e qëndrueshëm të ujit, dhe zbatimin e saj në përputhje me parimin e subsidiaritetit (Nenet 1 dhe 4). Integrimi i mbrojtjes dhe administrimit të qëndrueshëm të ujit në fusha të tjera të politikës së Komunitetit të tilla si energjia, transporti, bujqësia, peshkimi dhe turizmi (Nenet 1, 4, 5 dhe 9). Përcaktimi i përkufizimeve të përbashkëta për gjendjen e ujit në drejtim të cilësisë, dhe atje ku është e përshtatshme për qëllimin e mbrojtjes së mjedisit, të sasisë (Nenet 2, 4(1)(a) dhe 16(7), si edhe Shtojcat V, VIII dhe IX).

Forcimi i legjislacionit mjedisor

Miratimi i një kuadri legjislativ koherent, transparent dhe të efektshëm (duke përfshirë një legjislacion efektiv), ndjekja e parimeve të përbashkëta, dhe nëse është e nevojshme, caktimi i specifikimeve teknike dhe kërkesave minimale për standartet e përbashkëta të cilësisë mjedisore si edhe i vlerave kufi të shkarkimeve (Nenet 16 dhe 17, Shtojcat II dhe III, V, VI, VIII, IX dhe X).

Bashkëpunimi ndërkufitar

Dhënia e kontributit për të bërë të mundur që Komuniteti dhe Vendet Anëtare të përmbushin detyrimet e tyre në bazë të marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare të cilat përmbajnë detyrime të

rëndësishme në lidhje me mbrojtjen dhe administrimin e ujërave (Nenet 1, 3, 4(1), 12, 16(3) dhe (5)). Dhënia e kontributit në fusha të tjera të bashkëpunimit ndërmjet Vendeve Anëtare, të tilla si Perspektiva e Zhvillimit Hapësinor Evropian.

Mbrojtja e burimeve natyrore

Zgjerimi i fushës së zbatimit të mbrojtjes së ujit në të gjitha llojet e ujërave, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ato bregdetare dhe ku është e përshtatshme ujërat territoriale (Nenet 1-5, 7-8, 11-12 dhe 16-17). Mbrojtja e ekosistemeve ujore, si edhe e ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga to (veçanërisht Neni 6 dhe Shtojca IV). Mirëmbajtja dhe përmirësimi i mjedisit ujor në Komunitet, së pari nëpërmjet "qasjes së kombinuar" të kontrolleve të cilësisë, por gjithashtu edhe nëpërmjet rregullimit të sasisë, si përmes një integrimi më të ngushtë (Neni 10 dhe Shtojca IX). Kontributi për reduktimet progresive të shkarkimeve të substancave të rrezikshme në ujë dhe, së fundmi, eliminimi i substancave të rrezikshme prioritare në ujë (Nenet 4 dhe 16). Kontributi për arritjen e vlerave bazë për substancat që gjenden natyrshëm në ujërat detare (Neni 4). Arritja e "gjendjes së mirë" për të gjitha ujërat deri në një afat të caktuar si edhe ruajtjes së "gjendjes së mirë atje ku ajo ekziston tashmë" (Neni 4). Identifikimi dhe prapësimi i çdo tendence të rëndësishme dhe të qëndrueshme në rritje në përqendrimin e çdo ndotësi në ujërat nëntokësore (Neni 4, dhe Direktiva 2006/118/EC).

Administrimi i burimeve natyrore

Mbrojtja dhe zhvillimi i përdorimeve të mundshme të ujërave të Komunitetit (veçanërisht Nenet 1, 4, 9, 11, 13 dhe Shtojca VII).

Krijimi i një qasjeje për administrimin e ujit duke u bazuar tek basenet e lumenjve, parashikimi i bashkëpunimit ndërmjet Vendeve Anëtare atje ku basenet e lumenjve apo efektet e tyre janë ndërkufitare, si edhe parashikimi i një bashkëpunimi të mëtejshëm me Vendet jo-Anëtare atje ku basenet e lumenjve kufizohen pjesërisht me Komunitetin (Neni 3).

Mbrojtja nga përmytjet

Të kontribuojnë në reduktimin e efekteve të përmytjeve² (Neni 1 dhe 11(3) (I)).

Rikuperimi i kostove

Të kërkojnë marrjen parasysh të parimit të rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit, duke përfshirë edhe kostot mjedisore dhe ato të burimeve, si edhe të hartojnë politikat e caktimit të çmimeve të ujit duke vendosur stimujt e duhur për një përdorim sa më efikas të ujit. Të kërkojnë një kontribut të mjaftueshëm në rikuperimin e kostove të shërbimeve të ujit nga përdorues të ndryshëm të ujit (Neni 9 dhe Shtojca III).

Pjesëmarrja e aktorëve kryesorë dhe komunitetit

Të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në zbatimin e kësaj Direktive, veçanërisht përsa i përket hartimit, rishikimit dhe përditësimit të planeve të administrimit të baseneve të lumenjve (Neni 14).

² Shikoni gjithashtu Direktivën 2007/60/EC për vlerësimin dhe administrimin e reziqeve nga përmytjet

2.3 Kërkesat/Implikimet Indirekte

Direktiva vendos detyrimet e mëposhtme indirekte:

- Ndryshimet e kompetencave të institucioneve përkatëse në sektorin e ujit;
- Përmirësimi i kanalizimeve dhe i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Ndryshimet në procedurat e regjistrimit dhe dhënies së lejes për subjektet ekonomike .

Meqë Direktiva shërben gjerësisht si një kuadër gjithëpërfshirës për një numër direktivash të tjera, kërkesat indirekte për zbatimin e Direktivës i referohen kryesisht vënies në zbatim të direktivave të tjera, të tilla si Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC), Direktiva për PKNI-në (2008/1/EC) dhe Direktiva për Nitratet (91/676/EEC), si edhe përmbushja e standarteve dhe kërkesave të reja që kanë të bëjnë me substancat e listës prioritare.

2.4 Lidhjet me Legjislacionin tjetër

Lidhjet me legjislacionin tjetër brenda këtij sektori:

Zbatimi i Direktivës në fjalë është i lidhur ngushtë me disa direktiva të tjera të sektorit të ujit, si më poshtë:

- Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EC);
- Direktiva për Nitratet (91/676/EEC);
- Direktiva për Ujërat Banjatore (2006/7/EC);
- Direktiva për Ujin e Pijshëm (98/83/EC)
- Direktiva për Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore (2006/118/EC);
- Direktiva për Rreziqet nga Përmytjet (2007/60/EC).

Disa pjesë të legjislacionit të cilat datojnë afërsisht nga viti 1975 deri në vitin 1980 janë integruar në këtë Direktivë. Për pasojë, këto pjesë të legjislacionit po shfuqizohen në bazë të një qasjeje të përbërë nga disa faza, si më poshtë:

- Direktiva për Substancat e Rrezikshme (76/464/EEC) dhe direktivat e saj bija;
- Vendimi i Këshillit për Shkëmbimin e Informacionit (77/795/EEC);
- Direktiva për Peshqit e Ujërave të Ëmbla (78/659/EEC);
- Direktiva për Ujërat e Molusqeve (79/869/EEC);
- Direktiva për Matjen dhe Marrjen e Kampionëve të Ujërave Sipërfaqësore (79/869/EEC);
- Direktiva për Ujërat Nëntokësore (80/68/EEC).

Lidhjet me legjislacionin tjetër brenda sektorëve të tjerë:

- Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (85/337/EEC);
- Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2001/42/EC);
- Direktiva për Aksesin ndaj Informacionit Mjedisor (2003/4/EC);
- Direktiva për Raportimin (91/692/EEC) dhe Vendimi (94/741/EEC);

- Direktiva për Llumrat e Përpunimit të Ujërave të Zeza (86/278/EEC);
- Direktiva për Landiljet (99/31/EC);
- Direktiva për Djegjen e Mbetjeve (2000/76/EC);
- Direktiva për Produktet e Mbrojtjes së Impanteve (91/414/EEC);
- Direktiva për Shpendët e Egër (79/409/EEC);
- Direktiva për Habitatet (92/43/EEC);
- Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes së Integruar (PKNI) (2008/1/EC);
- Direktiva Seveso II (96/82/EEC);
- Direktiva për Biocidet (98/8/EC).

Direktiva në fjalë gjithashtu synon të plotësojë një numër konventash ndërkombëtare, palë e të cilave janë Komuniteti dhe/ose Vendet Anëtare. Ato që kanë të bëjnë me Shqipërinë janë:

- Protokollin e Konventës së vitit 1976 për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja e shkaktuar prej Burimeve Tokësore (1980);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ndërkufitare të Ujit si edhe Liqeneve Ndërkombëtare (e miratuar nga Këshilli në vitin 1995).

3 Gjendja Aktuale

3.1 Politika e Qeversisë

Ligji për Burimet Ujore (LBU), i ndryshuar, përbën legjisllacionin kryesor për administrimin e burimeve ujore, ai parashikon mbrojtjen, zhvillimin, përdorimin dhe shpërndarjen e qëndrueshme të burimeve ujore, mbrojtjen nga ndotja etij. Ai gjithashtu krijon kuadrin institucional, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë të baseneve të ujit, për vënien në zbatim të politikës për burimet ujore.

Sipas këtij Ligji, uji është një e mirë publike, përdorimi i tij i lirë(falas) lejohet në raste të caktuara por në përgjithësi, ai i nënshtrohet kontrollit nga ana e shtetit. Kjo zbatohet si për ujërat detare ashtu edhe ato të ëmbla. Të gjitha ujërat nëntokësore i nënshtrohen kontrollit, madje edhe ato që përdoren për qëllime individuale familiare.

LBU-ja kërkon gjithashtu edhe hartimin e një strategjie për ujin. Strategjitë për Sektorët e Furnizimit me Ujë dhe të Kanalizimeve për Shqipërinë u miratuan në shtator të vitit 2003³. Kjo Strategji përfshin një Plan Veprimi afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Disa nga veprimet që përfshihen në Planin e Veprimit Afatmesëm për Sstrategjinë e Zbatimit janë :

- Reforma e administrimit
- Monitorimi dhe vendoja e standarteve krahasuese si edhe lehtësimi i informacionit për publikun
- Kualifikimi i personelit
- Ndërtimi i kapaciteteve për sektorin e ujit dhe të kanalizimeve
- Reforma ligjore dhe institucionale
- Fushata për ndërgjegjësimin e publikut dhe komunikimin në fushën e mbrojtjes mjedisore dhe administrimit të burimeve ujore
- Reforma për pjesëmarrjen e sektorit privat
- Reforma financiare
- Reforma për uljen e varfërisë

³ Sidoqoftë, kjo Strategji nuk është rishikuar që nga dita e miratimit të saj kështu që nuk merr parasysh programet e mëpasshme institucionale

- Reforma teknike
- Investimet
- Përditësimi i programit të investimeve kapitale afatmesme për zonat urbane dhe rurale
- Bashkërendimi i të gjitha programeve të investimeve të huaja për zonat urbane dhe rurale
- Bashkërendimi i të gjithë donatorëve të investimeve të huaja, OJQ-ve, si edhe organizatave të tjera që operojnë në këtë sektor
- Vazhdimi i diskutimeve me donatorët për të filluar projekte të reja për ujin në zonat urbane dhe rurale
- Përditësimi i standarteve, normave teknike dhe vendosja e standarteve në përputhje me realizueshmërinë e tyre nga pikëpamja financiare si edhe strategjinë afatgjatë (Hyrja në BE).

Shqipëria i ka përfshirë Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në Strategjinë e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Synimi i Zhvillimit të Mijëvjeçarit për sektorin e ujit është përmirësimi i aksesit ndaj furnizimit me ujë të sigurtë dhe të besueshëm si edhe përmirësimi i sistemit të kanalizimeve.

Strategjia e vitit 2007 për Sektorin e Mjedisit dhe ajo Ndërsektoriale (SSMNS), që ka të bëjë me administrimin e ujërave identifikon ndotjen e ujërave sipërfaqësore që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara si çështjen më kritike, duke përcaktuar synimet kryesore të sektorit në lidhje më këtë problem.

Objektivat e SSMNS-së dhe treguesit korrespondues të tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Objektivat dhe treguesit e SSMNS-së

Fusha	Objektivi	Treguesi	Synimi për 2009 (%)	Synimi për 2014 (%)
Kanalizimet urbane	Përmirësimi i kanalizimeve urbane	Popullata e lidhur me rrjetin e kanalizimeve	75	95
Trajtimi i ujërave të ndotura	Përmirësimi i trajtimit të ujërave të ndotura	Popullata e lidhur me impiantet e trajtimit të cilat plotësojnë standartet bazë të trajtimit të Direktivës për TUNU-ve	25	50
Kanalizimet rurale	Përmirësimi i kanalizimeve rurale	Popullata e lidhur me rrjetin e kanalizimeve apo sistemet septike	55	65

Objektivat që përfshihen tek SSMNS-ja janë:

- Sisteme administrimi më efikase dhe të qëndrueshme të sektorit të ujit
- Zbatimi i Projekteve Prioritare për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura
- Zbatimi i Projekteve Prioritare për administrimin e ujërave të ndotura
- Reduktimi i ndotjes së burimeve fikse të ujërave sipërfaqësore
- Përmirësimi i mbrojtjes së ujërave nëntokësore
- Përmirësimi i monitorimit të ujit

3.2 Rolet & Përgjegjësitë

LBU-ja krijoi Këshillin Kombëtar të Ujit (KKU), Sekretariatit e tij teknik si edhe Këshillat e Baseneve të Lumenjve.

Këshilli Kombëtar i Ujit

KKU-ja është organi përgjegjës për përcaktimin e politikës së ujit si edhe për marrjen e vendimeve kryesore përkatëse.

KKU-ja kryesohet nga Kryeministri. Ai përfshin ministrinë kryesore: Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve; Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Ministrinë e Shëndetësisë; Ministrinë e Brendshme; si edhe gjashtë prefektët e baseneve të lumenjve të interesuara. Çdo prefekt është kryetari i Këshillit të basenit përkatës.

Si i tillë, KKU-ja mund të ofrojë një forum të një niveli mjaft të lartë brenda të cilit mund të diskutohen çështjet e administrimit të burimeve ujore. Sidoqoftë, që nga krijimi i tij, takimet kanë qenë mjaft të rralla dhe, duke qenë se në të përfshihen kaq shumë ministra, KKU-ja efektivisht ka qenë asgjë më tepër se një nën-komitet i Këshillit të Ministrave.

KKU-ja dhe strukturat e tij kanë përgjegjësinë për administrimin e burimeve të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe bregdetare. Ato hartojnë strategjitë kombëtare dhe të baseneve dhe i zbatojnë ato pjesërisht nëpërmjet lejeve të përdorimit. Si përfundim, KKU-ja dhe strukturat e tij bëjnë kombinimin e një roli vendimmarrës me atë të politikëbërësit.

Sekretariati Teknik

Sekretariati Teknik (ST) i KKU-së përshkruhet në LBU si "agjencia ekzekutive" e KKU-së. ST-ja duhet të ketë përgjegjësi administrimi, duke përfshirë dhënien e lejeve dhe inspektimin; sidoqoftë, meqë për

shumë vitë me rradhë që nga krijimi i tij në vitin 1996 ai përbëhet prej një personi të vetëm, drejtori i tij, përgjegjësitë praktike të administrimit të ujërave mbeten të fragmentarizuara me organe të tjera të përfshira në aspekte të ndryshme të tij. .

Që nga vera e vitit 2005, ST-ja u transferua nga Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të Territorit , ku ndodheshin zyrat dhe stafi i tij i mëparshëm , në MMPAU ku është bërë pjesë e “Sektorit të Politikës së Ujit” brenda Drejtorisë së Mbrojtjes së Natyrës.

Këshillat e Baseneve të Lumenjve

LBU-ja e ndan Shqipërinë, për qëllimet e administrimit të ujërave , në basene ujore, dhe krijon Këshillat e Baseneve të Lumenjve(KBL) si “autoritetet vendore përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse”.

Përsa i përket veprimtarisë së tyre KBL-të lëshojnë: a) leje për përdorimin e sasive të specifikuara të ujit për një qëllim të veçantë për një kohë të caktuar, si edhe b) koncesione, kryesisht për nxjerrjen e zhavorrit, në vijim të kërkimeve të ndërmarra në bazë të autorizimeve të dhëna nga KKU-ja.

Në vitin 2002 u krjuan gjashtë KBL respektivisht për: basenet e Drinit dhe Bunës, Matit, Ishmit dhe Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës.

Programi aktual administrativ paraqet një numër problemesh. Në veçanti: a) KBL-të nuk janë domosdoshmërisht përgjegjëse për të gjithë zonën ujëmbledhëse të lumit, por vetëm për pjesë të saj. Me fjalë të tjera, një nga përfitimet kryesore të qasjes së baseneve të lumenjve , për momentin , nuk ekziston më; b) KBL-të përbëhen nga zyrtarë të qeverisë qendrore dhe asaj vendore, dhe një e treta nga përfaqësues të komunitetit të biznesit, dhe secili prej tyre kryesohet nga Prefekti i Qarkut në të cilin ndodhet KBL-ja. Me fjalë të tjera, përdoruesit e ujit mbeten të papërfaqësuar në një shkallë të madhe; ndërkohë që një numër kaq i konsiderueshëm i përfaqësuesve të komunitetit të biznesit mund të rezultojë në një rrezik potencial për lindjen e konfliktit të interesave, veçanërisht meqë KBL-të japin leje dhe koncesione për përdorimin e ujit.

Agjencitë e Baseneve të Lumenjve (ABL) gjithashtu janë krijuar si një formë e krahut ekzekutiv të KBL-ve, edhe pse LBU-ja nuk i referohet ABL-ve. ABL-të janë përgjegjëse për hartimin e planit për burimet ujore, për përgatitjen e inventarit të burimeve ujore, si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe cilësore. Gjithashtu, ABL-të janë të përfshira në lëshimin e lejeve, koncesioneve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit si edhe për shkarkimet e ujërave të ndotura në trupat ujorë. Përveç mungesës së një statusi të qartë ligjor, ABL-të vuajnë edhe nga mungesa e zyrave, stafit dhe pajisjeve bazë të zyrave.

Në nivelin qëndror, detyrat përkatëse të administrimit të ujit tradicionalisht janë ndarë ndërmjet organeve të ndryshme administrative të administratës shtetërore:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Brenda MMPAU-së , Drejtoria e Politikave për Mbrojtjen e Natyrës-Sektori për Politikën e Ujit, Drejtoria e Politikave për Parandalimin e Ndotjes, si edhe Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe e Dhënies së Lejeve merren me çështjet e administrimit të ujërave (duke përfshirë lejet për shkarkimet e ujërave) si edhe mirëmbajtjen e cilësisë së ujit.

Gjithashtu një numër **Institutesh Specifike** aktualisht kanë kontrata më MMPAU-në për ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me monitorimin e ujit. Këto janë: *Instituti i Hidrometeorologjisë*(sasia dhe cilësia e ujërave sipërfaqësore), *Instituti i Studimeve Gjeologjike*(cilësia e ujërave nëntokësore), si edhe *Instituti i Mjedisit*(shkarkimet e Ujërave të Ndotura).

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Kjo Ministri është përgjegjëse për një nga sektorët kryesorë të përdorimit të ujit, shprehimisht për ujitjen në bujqësi. Si e tillë, Ministria ka përgjegjësi për shfrytëzimin e ujit për ujitje.

Janë krijuar gjashtëmbëdhjetë Borde Kullimi ⁴ të cilat janë përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së kullimit të tokës dhe mbrojtjes nga përmbytjet.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Brenda kësaj Ministrie, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve ka një status të veçantë. Struktura e saj është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe ndërkohë që ajo raporton para MPPTT-së ajo nuk është zyrtarisht pjesë e strukturës të asaj Ministrie. Drejtoria është përgjegjëse për problemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve.

Strategjia për Sistemin e Ujësllës-Kanalizimeve Rurale kërkon krijimin e një Agjencie për Ujësllës-Kanalizimet Rurale për të mbështetur “Shoqatat e Komunitetit të Ujit”. Deri tani, nuk është krijuar asnjëra prej këtyre strukturave .

Ministria e Shëndetësisë

Kjo Ministri, nëpërmjet Institutit të Higjenës dhe Epidemiologjisë si edhe Inspektoriatit Shtetëror të Shëndetësisë, është përgjegjëse për vendosjen e standarteve për ujin e pijshëm dhe për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe të ujërave banjatore.

⁴ Vini re që këto Borde Kullimi janë krijuar në bazë të Ligjit Nr. 8515 për Ujitjen dhe Kullimin. Disa përkthime të LBU-së (Neni 8) i cili i referohet KBL-ve, i quan ato Borde Kullimi. Për të mënjeluar konfuzionin, enti i krijuar në bazë të LBU-ja do të quhet KBL në këtë raport.

Enti Rregullator i sektorit të Ujit

Ky “Ent” u krijua në vitin 1998 në bazë të Ligjit Nr. 8102 “ Për Kuadrin Rregullator të Administrimit të Ujësjellës-Kanalizimeve” të datës 28 mars 1996. Veprimtaritë kryesore të këtij Enti janë: a) licensimi i personave fizikë apo juridikë për të operuar në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe, b) vendosja e tarifave për sektorët e ujësjellës-kanalizimeve.

Përsa i përket vendosjes së tarifave, Enti ka hartuar dhe përcjellë një strategji mbi të cilën mbështetet caktimi i tarifave. Kjo metodologji është lëshuar si një rregullore nga Enti i cili i merr këto kompetenca në bazë të Ligjit Nr 8102. Sidoqoftë, pas ndryshimeve të bëra në ligj, fjalën e fundit do ta ketë qeverisja vendore dhe Enti do të ketë vetëm një rol mbikëqyrësi.

Në nivelet rajonale dhe lokale, sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (Nr. 8652/2000), autoritetet vendore morën përsipër përgjegjësinë për administrimin e furnizimit me ujë dhe mbledhjen e ujërave të ndotura, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytjet që në fillim të vitit 2002.

3.3 Kuadri Ligjor Aktual

Ligji Nr. 8093 datë 21.3.1996 ‘Për Burimet Ujore⁵’ (i ndryshuar me Ligjin Nr. 8375 të datës 15.7.1998, Ligjin Nr. 8605 të datës 20.4.2000, dhe Ligjin Nr. 8736 të datës 01.2.2001) parashikon një kuadër gjithëpërfshirës për administrimin e burimeve të ujit në Shqipëri.

LBU-ja përcakton statusin ligjor të ujit dhe pronave të ujit, veprimtaritë dhe organizimin e administrimit e ujërave, kushtet e përdorimit të ujit, mbrojtjen e ujit, zhvillimin, përdorimin dhe shpërndarjen e qëndrueshme të burimeve ujore, mbrojtjen nga ndotja si edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me administrimin e ujërave.

Legjislacioni tjetër kryesor përfshin:

- Ligjin Nr. 8102 datë 28.3.1996 ‘Për Kuadrin Rregullator të Administrimit të Ujësjellës-Kanalizimeve’ (i ndryshuar);
- Ligjin Nr. 8515 datë 30.7.1999 ‘për Ujitjen dhe Kullimin’;
- Ligjin Nr. 9115 datë 24.7.2003 ‘Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura’;
- Ligjin Nr. 8905 datë 6.6.2002 ‘Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimi’;
- Ligjin Nr. 9103 datë 10.7.2003 ‘Për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare’;
- Ligji Nr. 8681 datë 2.11.2000 ‘Për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e Pritave dhe Pritave me Mbushje Skorjesh ; dhe

⁵ Gjithashtu i quajtur ndryshe edhe Ligji për Burimet Ujore dhe Ligji për Rezervat e Ujit

- Ligjin Nr. 8934 datë 5.9.2002 ‘Për Mbrojtjen e Mjedisit’ (i ndryshuar).

Rrethet e baseneve të lumenjve

LBU-ja përfshin parimin e baseneve të lumenjve dhe kërkon zbatimin e tij nëpërmjet krijimit të strukturave të transferuara: Këshillat e Baseneve të Lumenjve.

Në vitin 2006 territori i Shqipërisë u nda në gjashtë basene ujore dhe u krijuan strukturat korresponduese për administrimin e tyre.⁶

Basenet ujore përfshijnë një ose më shumë zona ujëmbledhëse të rrjedhave kryesore të ujit të lumenjve, apo pjesë të tyre, duke krijuar një ent hidrogjeografik natyral, ndërsa zona ujëmbledhëse përfshin, brenda një baseni ujqor, një ose më shumë zona ujëmbledhëse të rrjedhave jo kryesore të ujit. Sidoqoftë, programi aktual administrativ nuk i ndjek plotësisht kriteret hidrogjeografike dhe hidrologjike, dhe një numër KBL-sh funksionojnë në bazë të kufijve historikë administrativë të menaxhimit të ujit; të cilat nuk përputhen plotësisht me kriteret e DKU-së.

RBL-të Ndërkombëtare

Tre liqenet kryesore ndërkombëtare në kufijtë e Shqipërisë (i Prespës, Ohrit dhe Shkodrës) janë objekt i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar të nënshkruara respektivisht me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Pjesët shqiptare të këtyre liqeneve gjithashtu rregullohen edhe nga Ligji Nr. 9103 datë 10.7.2003 ‘Për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare’.

Republika e Shqipërisë ka miratuar dhe ratifikuar një numër Marrëveshjesh Mjedisore Ndërkombëtare. Tabela e mëposhtme paraqet një vështrim të përgjithshëm të gjendjes aktuale në këtë sektor.

Tabela 3: Gjendja e miratimit dhe ratifikimit të Marrëveshjeve Mjedisore Shumëpalëshe

Konventa	E nënshkruar	E ratifikuar
Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ndërkufitare të Ujit dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Konventa për Ujin)	Po	Po
Protokolli për Ujin dhe Shëndetin	Po	Po
Konventa e Aarhusit	Po	Po
Konventa RAMSAR	Po	Po
Ligji për Përdorimet jo për Lundrim të Rrjedhave Ndërkombëtare të Ujit (Konventa		Po

⁶ Lumenjtë Drini-Buna, Mati, Ishmi-Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa.

për Ujin)		
Konventa për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekstin Ndërkufitar (Espoo)	Po	Po
Protokolli për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (SEA Protocol)	Po	Po

Strategjia e Ujit

LBU-ja përmban dispozita për hartimin e strategjisë kombëtare të ujit (SKU) dhe kërkon përpilimin e planeve kombëtare dhe të baseneve të lumenjve (Nenet 9 dhe 10).

Synimet dhe objektivat e strategjisë kombëtare të ujit janë parashikuar në LBU si më poshtë:

- SKU-ja përcakton objektivat kombëtare në fushën e burimeve ujore dhe të strukturave institucionale për zbatimin e strategjisë;
- Ajo tregon mënyrën e përmbushjes së përdorimeve të ndryshme të ujit;
- Ajo identifikon programet dhe projektet prioritare;
- Ajo promovon ruajtjen e burimeve ujore si edhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

Planet e Administrimit të Rretheve të Baseneve të Lumenjve

Në bazë të Nenit 10 të LBU-së, duhet hartuar një plan për burimet ujore të baseneve të lumenjve për çdo basen kullimi. Sidoqoftë, procedurat për hartimin, rishikimin dhe miratimin e planeve, të cilat duhet të përcaktohen nëpërmjet një rregulloreje të veçantë ende nuk janë miratuar dhe deri tani nuk është përgatitur asnjë plan për burimet ujore të baseneve të lumenjve.

Mbrojtja e Ujit

Kreu 6 i LBU-së duhet të parashikojë dispozitat për kontrollin dhe ruajtjen e cilësisë së burimeve ujore. Sidoqoftë, në bazë të Nenit 26, këto janë parashikuar vetëm për vendosjen e standarteve për cilësinë e ujit të pijshëm, ndërkohë që është përfshirë edhe një regjim për rregullimin e punimeve në kanalizime dhe shkarkimin e mbetjeve në ujë në bazë të pëlqimeve (miratimeve). (Nenet 27 deri 36).

Nenet 40 deri 49 të LBU-së parashikojnë përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe të bregdetit, dhe përmbajnë dispozita për mbrojtjen e brigjeve të lumenjve.

Çështja e cilësisë së ujit trajtohet më tej në Ligjin Nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” (“Ligji për Ndotjen e Ujit”). Sidoqoftë, fokusi vihet vetëm mbi shkarkimin e ndotësve në trupat e ujërave sipërfaqësore, dhe jo në cilësinë e

ujërave në përgjithësi. Në Kreun 1 të këtij Ligji, në të vërtetë thuhet që qëllimi i tij është mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura duke specifikuar rregulla detyruese për trajtimin e tyre.

Në Nenin 8 të Ligjit për Ndotjen e Ujit kërkohet trajtimi i ujërave të ndotura industriale në varësi të llojit të industrisë së përfshirë dhe përvijohet në terma të përgjithshme procesi i trajtimit. Pas trajtimit të tyre, ujërat e përdorura mund të shkarkohen, me kusht që ato të përmbushin normat e pastrimit dhe çështja e trajtimit duhet të merret parasysh që në momentin e projektimit.

VKM Nr. 177 "Për Normat e Lejuara të Shkarkimit dhe Kriteret e Zonimit të Mjedisëve Pritëse Ujore" u nxorr në bazë të Ligjit për Ndotjen e Ujit më 31 mars 2005. Kreu i dytë i VKM-së trajton standartet e shkarkimit në ajër dhe ujë nga veprimtaritë industriale duke iu referuar tre shtojcave të bashkëngjitura, ndërkohë që Kreu 3 merret me "normat e lejuara të shkarkimeve urbane", si edhe me trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Ligji Nr. 8905 'Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimi' i miratuar më 6 qershor 2002 ka si qëllim mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi nëpërmjet parandalimit të dëmtimit të veprimtarisë së njeriut në zonën detare dhe atë bregdetare.

Lejet e Ujit

Leja për përdorimin e ujit kërkohet (Neni 14 i LBU-së) për qëllimet e mëposhtme:

- Përdorimin e ujit nëpërmjet impianteve të përhershme;
- Ujitje;
- Bagëtinë;
- Akuakulturën;
- Përdorimin industrial të ujit;
- Përdorimin e ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme, duke përfshirë edhe atë familiar;
- Mbjelljen e pemëve dhe drithërave në brigjet dhe shtratet e lumenjve, kur ato pengojnë përdorimin natyral të ujit;
- Largimin e materialeve të ngurta nga brigjet dhe shtratet e lumenjve, përrenjve dhe rezervuarëve, me ose pa ujë;

Në Nenin 16 të LBU-së parashikohet që përdorimet e ujit për qëllime publike, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë të pijshëm, prodhimin e energjisë elektrike si edhe për tregtinë e ambalazhimit të ujit në shishe duhet të bëhen në bazë të koncesionit të dhënë nga KKU-ja.

Lejet për përdorimin e ujit lëshohen nga KBL-të për një periudhë jo më të gjatë se 5 vjet, më përjashtim të lejeve për përdorimin e ujit për të cilat lëshohen për jo më shumë se 10 vjet.

Një leje, autorizim apo koncesion i dhënë nga KBL kërkohet nga Neni 27 i LBU-së për shkarkimet në “ujë, tokë, nëntokë apo në gropa”.

Monitorimi

VKM Nr. 103 në lidhje me Monitorimin Mjedisor në Republikën e Shqipërisë, i vitit 2002 krijon bazën ligjore mbi të cilën ndërmerren veprimtaritë monitoruese mjedisore në Shqipëri, duke përfshirë edhe monitorimin e ujit.

Ai përcakton listën e “treguesve të gjendjes së mjedisit” dhe “treguesit mjedisorë” të “ndikimit mjedisor”. Në Vendim renditen një numër treguesish që përfshihet tek të dyja kategoritë, ndër të tjera edhe veprimtaritë e industrisë së rëndë apo ato bujqësore.

Përgjegjësia e përgjithshme për projektimin e Programit Kombëtar të Monitorimit Mjedisor bie mbi MMPAU-në e cila është gjithashtu përgjegjëse për bashkërendimin e programeve të monitorimit. Institucione të ndryshme përdorin programin e monitorimit në bazë të kontratave të lidhura me MMPAU-në.

Zbatimi

Në Kreun XVI të LBU-së përcaktohen penalitetet për shkeljet e ligjit dhe të legjislacionit dytësor. Nenet 60 deri 68 përshkruajnë shkeljet dhe sanksionet specifike për to.

Aspektet ekonomike

Kreu XV i LBU-së trajton rregullimin e të ardhurave në administrimin e ujërave; Nenet 57 deri 59 parashikojnë dispozitat për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit, në normat e caktuara nga Këshilli i Ministrave, për pagesën e kostove administrative si edhe për dispozitat e stimujve financiarë.

3.4 Gjendja Aktuale e Zbatimit

3.4.1 Legjislacioni

Brenda kuadrit Projektit për Legjislacionin dhe Planifikimin Mjedisor-Shqipëri (ELPA) u propozuan një numër ndryshimesh në Ligjin për Burimet ujore⁷. Këto projekt-ndryshime të bëra nga projekti ELPA kishin dy qëllime kryesore: së pari bërja e përmirësimeve të konsiderueshme në LBU si ligji bazë për ujin; dhe së dyti sigurimi i një bazë ligjore për të gjithë legjislacionin e BE-së për ujin nëpërmjet përdorimit të legjislacionit dytësor (akteve nënligjore).

⁷ Edhe pse ndryshimet e bëra quhen amendamente, më shumë se një e treta e neneve të LBU-së janë amenduar, dhe prandaj, në përputhje me praktikën shqiptare, duhet hartuar një LBU të re.

Projekti aktual kreu një analizë të hollësishme të boshllëqeve ligjore duke përdorur Tabelën e Përputhshmërisë (TP) për të identifikuar mangësitë në statusin e transpozimit ligjor të Direktivës Kuadër për Ujin. Kjo analizë e detajuar e boshllëqeve ligjore i mori projekt-ndryshimet e LBU-së si pikën fillestare.

Analiza e mangësive tregon se Direktiva Kuadër për Ujin ende nuk është transpozuar plotësisht në legjislacionin shqiptar- madje edhe nëse merren parasysh projekt-amendamentet që do t'i bëhen LBU-së. Boshllëqet kryesore përfshijnë:

- Një numër përkufizimesh ende mungojnë ose nuk janë transpozuar plotësisht, duke përfshirë “lumë”, “liqen”, “trup i ujërave sipërfaqësore”, “akuifer”, “trup ujërash nëntokësore”, “nënbasen”, “gjendje e mirë e ujërave sipërfaqësore”, “gjendje e mirë e ujërave nëntokësore”, “status i mirë ekologjik”, “gjendje e mirë kimike e ujërave nëntokësore”, “burim i disponueshëm i ujërave nëntokësore”, “gjendje e mirë sasiore”, “shkarkim i drejtpërdrejtë në ujërat nëntokësore”, “objektiva mjedisore”, “qasje e kombikuar”, “kontrollat e shkarkimeve në ajër”.
- Nuk ekziston asnjë detyrim ligjor për të identifikuar dhe caktuar ujërat nëntokësore dhe ato bregdetare RBL-së më të afërt apo të përshtatshme.
- Në Nenin 4 mungojnë objektivat mjedisore, duke përfshirë të gjitha detajet.
- Në Nenin 5-mungojnë detyrimi për kryerjen e një analize të karakteristikave të RBL-së, shqyrtimi i ndikimeve mjedisore tek veprimtaria e njeriut si edhe analiza ekonomike e përdorimit të ujit.
- Në Nenin 6 mungon detyrimi për të krijuar dhe mbajtur një regjistër të zonave të mbrojtura.
- Në Nenin 7 , detyrimi për të identifikuar dhe monitoruar trupat ujorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm nuk është transpozuar plotësisht- në LBU është siguruar baza ligjore por mungojnë detajet.
- Në Nenin 8, detyrimi për të hartuar programet për monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore, gjendjes së ujërave nëntokësore dhe monitorimin e gjendjes së zonave të mbrojtura nuk është transpozuar plotësisht- baza ligjore është siguruar në projekt-LBU-në por detajet mungojnë.
- Baza ligjore për marrjen në shqyrtim të parimit të rikuperimit të kostove të ujit (Neni 9) mungon.
- Nuk përmendet fare kontrolli i shkarkimeve nëpërmjet një qasjeje të kombinuar (Neni 10).
- Mungojnë detajet e programit të masave që duhen hartuar për çdo RBL (Neni 11).
- Nuk është bërë transpozimi i të gjitha kërkesave që duhet të përfshihen në PABL-të (Neni 13).
- Mungon pjesa më e madhe e detajeve të konsultimit me publikun. (Neni 14)

- Ende duhet të bëhet transpozimi i përmbajtjes së të gjitha Shtojcave.
- Asnjë prej detajeve të parashikuara në Direktivën 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nuk është transpozuar.
- Asnjë prej dispozitave kryesore për administrimin e rrezikut të përmytjeve (Direktiva 2007/60/EC) nuk është transpozuar.

Gjithashtu, mund të konkludohet që legjislacioni ekzistues për ujin në Shqipëri ka një nivel të lartë dublimesh (dhe si rrjedhojë pështjellimesh) si përsa i përket fushës së zbatimit ashtu edhe përmbajtjes së këtij legjislacioni. Për shembull, LBU-ja zbatohet për të gjitha ujërat tokësore dhe për ato detare; por ekziston gjithashtu edhe Ligji për Ndotjen Detare si edhe Ligji për Liqenet Ndërkufitare i cili zbatohet për pjesët shqiptare të atyre ujërave tokësore. Shkarkimet në ujë rregullohen si nga LBU-ja ashtu edhe nga Ligji për Ndotjen e Ujit.

3.4.2 Programet Institucionale

Përsa i përket implementimit dhe zbatimit të DKU-së, aktorët kryesorë dhe rolet e tyre në këtë proces janë identifikuar ashtu siç përshkruhen në paragrafin 3.2. Një përmbledhje në format tabelle e aktorëve kryesorë dhe e roleve të tyre në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kërkesave të DKU-së është paraqitur në Tabelën 1.

Implementimi i Direktivës nënkupton zbatimin e një politike të qëndrueshme të ujit e cila hartohet mbi një bazë të integruar. Kjo përfshin:

- Integrimin dhe bashkërendimin më të madh ndërmjet politikës së administrimit të ujit dhe politikave të tjera, të tilla si ato të bujqësisë, zhvillimit urban etj.
- Bashkërendimin dhe bashkëpunimin më të madh ndërmjet MMPAU-së dhe ministrive të tjera, veçanërisht Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.
- Përmirësimin e bashkërendimit ndërmjet MMPAU-së dhe KBL-ve. Në veçanti, ndarja e përgjegjësive dhe detyrave duhet të përcaktohet më mirë në mënyrë që të ketë një kufi të qartë ndarës ndërmjet dy organeve.

Gjithashtu, zbatimi i DKU-së do të ketë ndikim tek të gjithë të interesuarit në administrimin dhe përdorimin e ujit në Shqipëri-industria e ujit, autoritetet vendore, të gjitha bizneset që kanë leje shkarkimi, leje për tregtimin e ujit apo leje për nxjerrjen e tij, autoritetet e lundrimit, si edhe industria, bujqësia dhe peshkimi më në përgjithësi.

Fushat kryesore ku duhet t'i jepet prioritet planifikimit për një integrim më të mirë janë:

- *Uji dhe bujqësia.* Kjo do të merret kryesisht me ndotjen e shpërhapur- në veçanti nitratet dhe pesticidet- por do të

- përfshijë gjithashtu edhe politikat për inkurajimin e një përdorimi sa më ekonomik të burimeve ujore nga bujqësia.
- *Uji dhe planifikimi i përdorimit të tokës.* Zhvillimi fizik mund të ketë ndikim tek burimet ujore dhe cilësia e tij. Duhet të sigurohet që udhëzimet për planifikimin e përdorimit të tokës të pasqyrojnë trynitë që kjo mund të ushtrojë tek uji, duke përfshirë edhe pasqyrimin e ndikimit të ndryshimit të klimës në periudhën afatgjatë (p.sh. nga vera më të nxehta dhe më të thata).
 - *Uji dhe biodiversiteti.* Uji ka një ndikim shumë të fuqishëm tek biodiversiteti si në ujë ashtu edhe rreth tij. Përmirësimet në cilësinë e ujit nëpërmjet Direktivës Kuadër për Ujin do të ishin një ndihmë mjaft e madhe. Por Direktiva nuk është instrumenti i vetëm. Ndryshimet në praktikën bujqësorë ka të ngjarë të luajnë një rol kryesor në këtë drejtim.
 - *Uji dhe turizmi, argëtimi dhe zbavitja.* Uji përbën një fokus të fuqishëm për veprimtaritë zbavitëse. Nganjëherë mund të ketë konflikte me objektivat e ruajtjes së ujit. Por në pjesën më të madhe këto veprimtari janë në harmoni me njëra-tjetrën, meqë turizmi ka nevojë për ujë tërheqës dhe të një cilësie të mirë. Kjo do të thotë që përfitimet financiare dhe ekonomike të turizmit në zonat lokale, duke përfshirë edhe ato rurale, ndihmojnë për të krijuar stimuj lokalë më të mëdhenj për të përmirësuar cilësinë e ujit.
 - *Uji dhe Përmytjet.* Përdorimi i zgjidhjeve të moderuara inxhinierike për të administruar problemet e përmytjeve mund të jetë i dobishëm edhe për cilësinë e ujit dhe biodiversitetin- edhe pse inxhinieria e lehtë nuk do t'i zgjidhë të gjitha problemet që shkaktojnë përmytjet. Përsëri, ndryshimet në praktikën e fermave dhe mënjanimi i zhvillimit të paqëndrueshëm fizik mund t'i sjellë dobi si administrimit të përmytjeve dhe cilësisë së ujit ashtu edhe burimeve të tij.
 - *Uji dhe shëndeti.* Do të jetë e nevojshme të sigurohet vazhdimisht që objektivat të jenë të harmonizuara me njëra-tjetrën. Një shembull i mirë do të ishte Direktiva e rishikuar e Komisionit të BE-së për ujërat banjatore.

Mund të konkludohet se programet administrative për administrimin e ujit në Shqipëri mund të përmbliidhen si pështjelluese, komplekse, të fragmentarizuara dhe të dubluara. Për shembull:

- Përgjatë linjave të vjetra administrative dhe jo në bazë të zonës ujëmbledhëse;
- Është e paqartë se si dhe ku 16 Bordet e Kullimit përshtaten me gjashtë Basenet e Ujit;
- KJU-ja kombinon rolin e politikëbërësit me atë të vendimmarrësit; d.m.th. duket se ai kryen disa nga detyrat që ka të ngjarë të trajtohen më mirë nga Sekretariati i tij Teknik ose nga KBL-të;

- Një gamë e gjerë autoritetesh lëshojnë 'leje'⁸ për përdorimin e ujit (nxjerrjen e tij) dhe për shkarkimet në ujë, duke përfshirë KKU-në, ST-në, KBL-në, MMPAU-në, me pak ose aspak bashkërendim ndërmjet këtyre organeve të ndryshme.

⁸ Për këto qëllime, "lejet" përfshijnë koncesionet, autorizimet, lejet etj.

Tabela 4: Aktorët kryesorë

Autoritetet dhe institucionet përgjegjëse	Detyrat e zbatimit	Identifikimi i baseneve të lumenjve dhe RBL-ve	Rrethet e Baseneve të Lumenjve Ndërkufitare (RBL)-të. Dhënia e efektit ligjor programeve administrative për lumenjtë, liqenet apo ujërat bregdetare ndërkombëtare.	Caktimi i autoriteteve kompetente. Informacioni bazë për administrimin e baseneve të lumenjve.	Identifikimi i ujërave përkatëse(basenet e lumenjve, trupat ujorë).	Arritja e objektivave mjedisore për ujërat sipërfaqësore/nëntokësore/zonat e mbrojtura	Analiza e karakteristikave të RBL-së	Shqyrtimi i ndikimit mjedisor të veprimtarisë së njeriut	Regjistri i zonave të mbrojtura	Ujërat e përdorura përnxjerrjen e ujit të pijshëm	Analiza ekonomike e përdorimit të ujit	Programet e monitorimit	Rikuperimi i kostove	Qasja e kombinuar	Përdorimi i mjedisit
Këshilli Kombëtar i Ujit		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>											
Sekretariati Teknik		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Këshillat e Baseneve të Lumenjve					<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>					<input checked="" type="checkbox"/>		
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>				<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>								<input checked="" type="checkbox"/>		
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>								<input checked="" type="checkbox"/>		
Ministria e Shëndetësisë		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>						<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>			
Enti Rregullator i Sektorit të Ujit				<input checked="" type="checkbox"/>							<input checked="" type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>		
Institutet Shkencore				<input checked="" type="checkbox"/>							<input checked="" type="checkbox"/>				
Qeverisja Vendore				<input checked="" type="checkbox"/>									<input type="checkbox"/>		

Legjenda: organ përgjegjës; organ i konsultuar organ i informuar

3.4.3 Procedurat Administrative

Janë konstatuar probleme të burimeve në lidhje me pajisjet e përdorura nga institucionet në nivel kombëtar (monitorimi, inspektimi, teknologjia e informacionit). Në nivelin lokal, mungesa e burimeve njerëzore është një nga të metat kryesore meqë numri i personelit është shumë i ulët se ai që kërkohet për një zbatim sa më të efektshëm të Direktivës. Gjithashtu, personeli ndien mungesën e pajisjeve kryesore, automjeteve si edhe të hapësirës së mjaftueshme të zyrave. Rekomandohet fuqimisht që investime shtesë për pajisje në nivelin lokal të bëhen të disponueshme. Sistemi i informacionit kërkohet jo vetëm duke pasur parasysh mekanizmat e raportimit. Rekomandohet që funksionet e lëshimit të lejeve dhe ato të inspektimit të mbështeten nga një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse elektronike dhe atje ku është e nevojshme edhe në kopje të printuara dhe sistemi për përpunimin e informacionit, si një sistem garantues cilësie i cili do të mbulonte të gjithë procesin rregullator.

Problemet e disponueshmërisë së të dhënave (ruajtja e kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave, ruajtja e përpunimit të të dhënave, shkëmbimi dhe përdorimi) janë evidentuar si një nga çështjet që kufizojnë mundësinë për të raportuar para të gjithë përdoruesve të interesuar, duke përfshirë edhe Komisionin. Rekomandohet që të hartohet një program për raportimin sistematik brenda kuadrit të një sistemi të vetëm informacioni për ujin, duke përfshirë edhe programin për menaxhimin e sistemit të informacionit të administrimit të ujërave.

3.5 Gjendja Aktuale e Investimeve

Direktiva parashikon një kuadër ligjor për një gamë të gjerë veprimesh, që synojnë arritjen e një gjendjeje të mirë për të gjitha kategoritë e ujërave (lumenjtë, liqenet, dhe ujërat nëntokësore) në Bashkimin Evropian deri në vitin 2015 tek Vendet Anëtare. Ndërmjet të tjerave ajo parashikon:

- Hartimin e parimeve bazë të një politike të qëndrueshme për ujin në Bashkimin Evropian,
- Hartimin e kuadrit menaxherial për të gjithë gamën e politikës dhe legjislacionit për mbrojtjen e ujit,
- Prezantimin e një qasjeje të baseneve të lumenjve në administrimin e ujërave,
- Arritjen e gjendjes së mirë të të gjithë ujërave sipërfaqësore deri në vitin 2015, dhe
- Monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore ;

Masat specifike për kontrollin e shkarkimeve të ndotësve në ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore janë përfshirë në direktiva të tjera, veçanërisht Direktiva për PKNI-në (2008/1/EC), Direktiva për Ujërat e Ndotura Urbane (91/271/EEC) dhe Direktiva për Nitratet(

91/676/EEC), gjithashtu edhe kostot e këtyre masave janë përcaktuar në këto direktiva të tjera. Investimet për reduktimet e shkarkimeve në ujë, në veçanti nëpërmjet rregullimit të shkarkimeve nga impiantet industriale dhe ndërtimit të sistemeve për mbledhjen e ujërave të ndotura dhe atyre të trajtimit janë marrë parasysh nga direktiva të tjera. Në këtë seksion merret në shqyrtim gjendja aktuale e investimeve në tre grupime d.m.th. investimet në njerëz dhe lehtësitë(pajisjet) që iu nevojiten atyre për zbatimin e kësaj Direktive, investimet në pajisjet e monitorimit, si edhe investime në asistencën e nevojshme teknike për vënien në zbatim të saj.

Investimet në njerëz dhe pajisje

Zbatimi i Direktivës në fjalë do të jetë një sfidë në vetvete sepse detyrimet e reja që ajo vendos do të kërkojnë përfshirjen e një personeli që ka ekspertizën e duhur. Për të siguruar që personeli të ketë ekspertizën që kërkohet, rekomandohet vënia në zbatim e projekteve mbështetëse, masave trajnuese dhe e projekteve të binjakëzimit, në mënyrë që të sigurohen mundësitë e nevojshme për të krijuar një mirëkuptim të përbashkët të kësaj Direktive, si edhe për të ndarë përfitimet e përvojës dhe ekspertizës që Vendet Anëtare kanë në dispozicion të tyre, gjithashtu edhe barrën e përgatitjes për zbatimin e saj gjatë viteve të ardhshme.

Ende nuk janë ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të vënies së të gjashtë KBL-ve (si edhe të strukturave të tyre teknike- Agjencia e Baseneve të Lumenjve) në pozitat e Autoritetit Kompetent për zbatimin e Direktivës, dhe përshtypja e fituar është që KBL-të janë në fazat fillestare dhe ende po përpiqen të gjejnë funksionin e tyre të vërtetë.

Investimet në softuerët dhe harduerët e nevojshëm për GIS(SIGJ)

Shumë nga veprimet e Direktivave kërkojnë trajtimin e të dhënave të shpërndara hapësinore dhe si të tilla mund të përfitojnë nga përdorimi i teknologjive të Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS-SIGJ). Gjithashtu, Direktiva shprehimisht kërkon raportimin e pjesës më të madhe të informacionit hapësinor në një format të pajtueshëm me atë GIS.

Konsiderohet që pajisjet GIS të ekzistojnë pjesërisht brenda departamentit përkatës në MMPAU. Informacioni Bazë Dixhital është i disponueshëm. Sidoqoftë, nevojiten disa përmirësime në harduerë (si plotera, skanera) dhe në softuerë. Në veçanti, duhet të krijohet një bazë të dhënash e integruar për burimet ujore dhe të lidhet me një sistem GIS për qëllimet e prezantimit të këtyre të dhënave.

As pajisjet GIS dhe as informacioni dixhital nuk janë të disponueshme në nivelin e KBL-ve.

Bazat e të dhënave duhet të krijohen pranë çdo KBL-je. Ato duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat përkatëse që kanë të bëjnë me burimet ujore (hidrologjia, lloji i dheut, përdorimi i tokës, trupat ujorë, sasia e ujit, cilësia e ujit, përdorimi i ujit, lejet, koncesionet etj.)

Investimet në pajisjet e monitorimit

Programet për monitorimin e cilësisë së ujit në Shqipëri janë relativisht të zgjeruara dhe përfshijnë pjesën më të madhe të zonave të ndotura dhe të “pikave të nxehta” mjedisore. Karakteristikat kimike dhe fizike të matura në stacionet e përzgjedhura të monitorimit nga autoritetet përgjegjëse kufizohen tek cilësia bazë e ujit dhe parametrat ushqyes me matje të kufizuara të metaleve të rënda, lëndëve organike, substancave prioritare dhe atyre të rrezikshme.

Të dhënat e monitorimit mjedisor në Shqipëri nuk janë të pranueshme për organizmat ndërkombëtare të tilla si EEA-ja dhe formojnë një bazë të dobët për politikën shqiptare, si edhe për vendimmarrjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut. Problemet përfshijnë mungesën e sigurimit të cilësisë së duhur në proceset e monitorimit dhe analizës, mungesën e projektimit të integruar, buxhetin e pamjaftueshëm për monitorimin, infrastrukturën e dobët dhe furnizimin e pasigurtë me energji elektrike⁹. Gjithashtu, duhen matur elementët e cilësisë biologjike si edhe karakteristikat hidromorfologjike për të mundësuar vlerësimin e trupave ujorë çka duhet bërë në përputhje me kërkesat e DKU-së.

Disa nga këto probleme po trajtohen aktualisht nga projekti në vazhdim StEMA të cilit i referohemi në shënimin e mëposhtëm në fund të faqes. Po projektohet një sistem i integruar monitorimi i cili ndërmjet të tjerave do të gjenerojë të dhënat e kërkuara për plotësimin e kërkesave të DKU-së. Projekti në fjalë gjithashtu përfshin masat për trajnimin e personelit në drejtim të procedurave të duhura të monitorimit.

Kërkesat e DKU-së për monitorimin janë të kushtueshme dhe kërkojnë mjaft kohë. Këto kërkojnë një personel të trajnuar dhe pajisje të specializuara. Shpenzimet kapitale, operative dhe ato të mirëmbajtjes për pajisje si edhe kostot e karburantit, pjesëve të këmbimit dhe kimikateve për instrumentet e sofistikuar analitike janë të konsiderueshme.

Investimet në ndërtimin e kapaciteteve

Uji është një sektor relativisht mjaft i njohur për investimet në Shqipëri nga donatorë të huaj. Mbi 180 milion Euro janë vënë në dispozicion të projekteve të ndryshme në këtë sektor nga financimet dypalëshe dhe shumëpalëshe gjatë tetë viteve të fundit.¹⁰ Sidoqoftë, pjesa më e madhe e këtyre parave u përdor dhe po përdoret për përmirësimin e infrastrukturës së ujit dhe të kanalizimeve. Ka pasur disa projekte të Asistencës Teknike gjatë viteve të fundit të cilat kanë ndihmuar për ndërtimin e kapaciteteve si edhe për përgatitjen e zbatimit të DKU-së në Shqipëri.

⁹ Konsulentët e PM: Rrjeti i sistemit të monitorimit të integruar mjedisor të Shqipërisë që ka të bëjë më zonat e përzgjedhura të marrjes së kampionëve, stacionet, parametrat dhe frekuencat. Raporti i hartuar nga projekti StEMA i financuar nga Komisioni Evropian, 3 tetor 2008.

¹⁰ Burimi: Republika e Shqipërisë, Ministria e Integritimit- Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, 2007-2012.

4 Plani i Përafrimit

4.1 Hyrje

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA) me Komunitetin Evropian dhe Vendet Anëtare të tij më 12 prill 2006, Shqipëria konfirmoi fuqishëm përkushtimin politik tashmë të shprehur mjaft qartë në drejtim të anëtarësimit të saj në BE.

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012, i miratuar nga Këshilli i Ministrave më 5 korrik 2006, në njëfarë mase siguron konfirmimin e përkushtimit të të gjitha institucioneve dhe nëpunësve civilë përkatës për përmbushjen e kërkesave të procesit të integritimit në BE.

Një nga kushtet kryesore për anëtarësimin në BE është integrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së, i ashtuquajtur i procesi i përafrimit, i cili përbëhet nga tre komponentë kryesorë: transpozimi ligjor, implementimi dhe zbatimi .

Plani i përgjithshëm për përafrimin e plotë paraqitet në paragrafët e mëposhtëm. Ai përbëhet nga plani i transpozimit ligjor dhe nga plani i implementimit (duke përfshirë edhe zbatimin).

Plani i transpozimit ligjor përbëhet nga pesë veprime të cilat në fillim do të sigurojnë disa rregullime/amendamente të LBU-së (ose përfshirjen e detyrimeve që mungojnë, ose riformulimin e dispozitave ekzistuese të cilat nuk janë plotësisht në përputhje me dispozitat përkatëse të Direktivës dhe dispozitat e qarta të bazës ligjore) si edhe hartimin e legjislacionit dytësor (akteve nënligjore).

Plani i zbatimit(implementimit) përbëhet nga një numër veprimësh të cilat janë konsoliduar në katër grupet kryesore të veprimeve të zbatimit (referojuni më poshtë Tabelës 2). Një përshkrim i hollësishëm i planit të zbatimit jepet në paragrafin 4.3.

4.2 Qasja në drejtim të kalendarit të veprimeve

Përgatitja e planeve për përafrimin e legjislacionit të BE-së të tillë si Direktiva Kuadër për Ujin përfshin hartimin e kalendarit të propozuar të veprimtarive. Hartimi i kalendarëve të tillë nuk është një çështje e

thjeshtë, dhe varet nga konsideratat dhe kriteret e mëposhtme(ndërmjet të tjerave):

1. Në rastin më të fundit, legjislacioni duhet të jetë transpozuar në ligjin kombëtar deri në datën e hyrjes në BE. Në parim, ai gjithashtu duhet edhe të jetë zbatuar në një shkallë të madhe. Ndërsa është e mundur të bëhet negociimi i disa periudhave tranzitore, p.sh. zgjatja e afatit përtej datës së hyrjes në BE për arritjen e përmbushjes, këto periudha tranzitore normalisht jepen për një numër të kufizuar direktivash që kanë “kosto mjaft të larta”, dhe pastaj vetëm për detyrime specifike të këtyre direktivave. Në këtë kuptim, DKU-ja nuk konsiderohet si një direktivë me “kosto mjaft të lartë”. Data e hyrjes së Shqipërisë në BE ende nuk është caktuar, por është pranuar gjerësisht që ajo nuk ka të ngjarë të jetë para vitit 2015.
2. Përafrimi përfshin kosto mjaft të larta (ndoshta disa miliardë Euro vetëm për legjislacionin mjedisor). Sa më e gjatë të jetë periudha e programuar për përafrimin (objekt i pikës 1 të mësipërme), aq më e madhe do të jetë barra e kostove dhe pagesave për burime të caktuara të kufizuara (p.sh. koha që juristët e qeverisjes qendrore kanë në dispozicion për hartimin e ligjeve). Ndryshe nga rritja e kostove për shkak të një programi më të zgjatur në kohë, kostot totale nganjëherë reduktohen(kjo ndodh veçanërisht në rastin e investimeve të bëra nga shoqëritë , kur shtyrja e afatit të një detyrimi për investim mund të lejojë harmonizimin e tij me plane të tjera investimesh, për të pasur një efikasitet më të madh).
3. ‘Prioriteti’ i masave. Për shembull transpozimi i legjislacionit kuadër i tillë si Direktiva Kuadër për Ujin konsiderohet nga Komisioni Evropian si i një prioriteti mjaft të madh.
4. Programimi në kohë i një veprimi apo veprimtarie të caktuar të zbatimit shpesh varet nga veprime të tjera, që kanë lidhje me të njëjtën direktivë ose nganjëherë me një pjesë tjetër të legjislacionit. Për shembull, nuk është shumë me vend zhvillimi i planeve për administrimin e baseneve të lumenjve derisa sistemi i monitorimit të japë rezultate të përdorshme. Por në mënyrë të ngjashme, një program masash që nevojitet për të arritur objektivat për ujë të përcaktuara në DKU është i parakohshëm para se të dihet se cilat masa duhet të zbatohen në bazë të Direktivave për UNU-të, PKNI-në dhe ajo e Nitrateve.

Për rrjedhojë, hartimi i një programi(kalendari) veprimtarish përfshin gjetjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet ndarjes së veprimeve në faza në mënyrë të tillë që kostot dhe burimet e pamjaftueshme të mos tejkalohen, ndërkohë që sidoqoftë i dëshmohet BE-së progresi i

mjaftueshëm dhe përmbushja e afateve të nevojshme të pajtueshme me aderimin në kohë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në caktimin e fazave në kohë të veprimeve të përafrit, qasja e përdorur ka qenë ajo e specifikimit të viteve relative (duke filluar nga viti 0), duke u mbështetur në një program minimal të rehatshëm, por duke anashkaluar kufizimet e burimeve. Në praktikë, ritmi me të cilin mund të transpozohen dhe zbatohen këto direktiva/rregullore do të varet nga disponueshmëria e burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe buxhetore të cilat duhet të ndahen me sektorë të tjerë mjedisorë¹¹. Kufizimet e burimeve nuk mund të zbatohen vetëm për PZDS-të individuale. Kur PZDS-të të jenë hartuar për të gjitha direktivat që duhen trajtuar në këtë projekt, mund të bëhet vlerësimi i panoramës së kostove të përgjithshme si edhe i rregullimeve të bëra për programet relative të përkohshme për të reflektuar konsideratat e shprehura më sipër, duke siguruar në këtë mënyrë propozime praktike dhe të realizueshme.

Elementët kryesorë të planit të përgjithshëm për përafritin e plotë jepen më poshtë në Tabelën 5 (duke filluar nga viti 0).

Tabela 5: Elementët kryesorë të planit të përgjithshëm të përafritit

Plani i përgjithshëm i përafritit	Fillimi (muaji/viti)	Mbarimi(muaji/viti)
<i>Transpozimi ligjor</i>	01/0000	06/0003
<i>Implementimi dhe Zbatimi</i>	07/0000	12/0004
• Forcimi institucional	07/0000	12/0002
• Përmirësimi i administrimit të baseneve të lumenjve	01/0001	12/0004
• Monitorimi dhe analiza e gjendjes së ujit	01/0001	12/0004
• Analiza ekonomike, planifikimi i administrimit të baseneve të lumenjve, programet e masave, raportimi	01/0001	12/0003

4.3 Plani i Transpozimit

Plani i transpozimit mbështetet tek gjetjet e analizës së boshllëqeve ligjore, të cilat në vetvete formojnë bazën për identifikimin dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet e ardhshme që kërkohen për përfundimin e transpozimit të direktivës Kuadër për Ujin- dhe

¹¹ Një program realist (absolut) i veprimtarive për transpozimin ligjor, implementimin dhe zbatimin e këtyre direktivave/rregulloreve, duke marrë parasysh burimet dhe buxhetet e disponueshme të kufizuara, duhet të hartohet si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Përafritin e Legjislacionit Mjedisor (që nuk është pjesë e studimit në fjalë) ku kërkesat për burime në të gjithë sektorët janë vendosur pranë njëra-tjetrës dhe krahasohen me burimet e disponueshme totale të përlogaritura.

Direktivës së re për Ujërat Nëntokësore si edhe Direktivës për Rreziqet e Përmbytjeve.

Këto veprime kanë si pikë fillestare projektin e LBU-së të hartuar nga projekti ELPA dhe mbështeten tek amendamenti i këtij projekt-ligji dhe përgatitja e legjislacionit dytësor në bazë të këtij projekti të ri të LBU-së. Këto veprime u hartuan dhe diskutuan me Ministrinë dhe aktorët e tjerë.

Siç u vërejt nga projekti ELPA, ekziston një numër dublimesh në pjesë të ndryshme të legjislacionit për ujin të cilat duhet të eliminohen, si për shkak të mbivendosjeve juridikionale ashtu edhe përsa i takon dhënies së lejeve me të njëjtën veprimtari që teorikisht kërkon një leje në bazë të tre pjesëve të veçanta të legjislacionit – dhe kjo para se të merret në shqyrtim “leja mjedisore” dhe “leja e integruar” sipas Ligjit për Mbrojtjen Mjedisore.

Veprimet kryesore të planit të transpozimit përfshijnë:

- Amendimin e LBU-së për transpozimin kërkesave kryesore të DKU-së dhe sigurimin e bazës ligjore për legjislacionin dytësor që nevojitet për përfundimin e këtij transpozimi;
- Shfuqizimin e Ligjit Nr. 9115 datë 24.7.2003 ‘Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura’ dhe transferimin e dispozitave përkatëse për ndotjen e ujit tek LBU-ja e ndryshuar;
- Shfuqizimin e Ligjit Nr. 9103 datë 10.7.2003 ‘Për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare’, i cili zbatohet vetëm për ato pjesë të atyre liqeneve që janë ujëra kombëtare – dhe që duhet të mbulohet tashmë nga LBU-ja dhe nëse është e nevojshme edhe transferimin e dispozitave përkatëse tek LBU-ja e amenduar;
- Transferimin e dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8905 datë 6.6.2002 ‘Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimi’ tek LBU-ja e amenduar në mënyrë që të mund të ndërmerret një qasje plotësisht e integruar për rrethet e baseneve të lumenjve ndaj kontrollit të ndotjes së të gjitha ujërave;
- Përgatitjen e VKM-së për Planet e Administrimit të Baseneve të Lumenjve në bazë të LBU-së i cili do të bëjë transpozimin e dispozitave kryesore të tre direktivave përsa i përket përmbajtjes, hartimit dhe zbatimit të këtyre planeve.

Përsa i përket elementit të fundit të sipërpërmendur, d.mth. Vendimi i Këshillit të Ministrave për Planet e Administrimit të Baseneve të Lumenjve, ky legjislacion dytësor do të hartohet nga projekti aktual në konsultim me MMPAU-në.

4.4 Plani i Zbatimit(implementimit)

Gjetjet kryesore të analizës së boshllëqeve ligjore të paraqitura në paragrafin 3.4 kanë formuar bazën për identifikimin dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet e kërkuara në të ardhmen për implementimin dhe zbatimin. Këto veprime do të mundësojnë zbatimin dhe implementimin e kësaj Direktive dhe përbëjnë esencën e Planit të Zbatimit.

Veprimet e nevojshme për sigurimin e implementimit dhe zbatimit të plotë të kësaj Direktive janë paraqitur në Tabelën 6 më poshtë së bashku me një përshkrim të shkurtër të secilit prej veprimeve të propozuara, instituciont përgjegjës dhe periudhës së propozuar të implementimit. Veprimet iu parashtruan Ministrisë, e cila paraqiti komentet përkatëse duke dhënë miratimin e saj.

Tabela 6: Veprimet e implementimit dhe zbatimit

Kërkesat e BE-së që përfshihen(Nenet)	Veprimi	Institucioni përgjegjës	Periudha e zbatimit (muaji/viti)
Neni 3(1)	Identifikimi dhe caktimi i ujërave nëntokësore dhe bregdetare rrethit të baseneve të lumenjve më të afërt apo të përshtatshëm	KBL-të	01/0000 - 12/0001
Neni 4	Përcaktimi i objektivave mjedisore që do të zbatohen në basenet e lumenjve .	KBL-të	07/0000 - 06/0001
Shtojcat II & III Neni5(1), 5(2)	Shqyrtimi i karakteristikave të baseneve të lumenjve	KBL-të	01/0000 - 12/0002
-	Vlerësimi i ndikimit të veprimtarisë së njeriut tek basenet individuale të lumenjve	KBL-të	07/0000 - 12/0003
Neni 6(1), 7(1) Shtojca IV -Neni 6(2)&(3)	Krijimi i një regjistri të zonave të mbrojtura në çdo rreth basenesh të lumenjve.	MMPAU -ja - KBL-të	01/0002 - 12/0003
Neni 7	Identifikimi dhe monitorimi i trupave ujorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm	MMPAU -ja KBL-të	01/0001 - 12/0001
Neni 8	Hartimi i programeve për monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore , nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura	KBL-të	01/0001 - 12/0001
Neni 11	Hartimi i një programi masash si pjesë e planeve të baseneve të lumenjve për arritjen e	KBL-të	01/0002 - 12/0004

	objektivave të caktuara mjedisore		
Neni 14	Caktimi i procedurave për konsultimin me publikun	KBL-të	01/0002 – 12/0002

Veprimet e renditura më sipër i referohen periudhës së nevojshme për ngritjen e sistemit të duhur për administrimin, mbrojtjen dhe raportimin e ujit. Ai nuk mbulon periudhën që nevojitet për arritjen e një cilësie sa më të mirë të ujit. Kjo periudhë do të përcaktohet pas përfundimit të monitorimit dhe analizave gjithëpërfshirëse siç parashikohet në planin e zbatimit. Arritja e një cilësie të mirë të ujit varet gjithashtu nga dinamika e zbatimit të direktivave të tjera që lidhen me të (në sektorin e ujit, në veçanti Direktiva për Ujërat e Ndotura Urbane (91/271/EEC) dhe Direktiva për Nitratet (91/676/EEC) si edhe direktivat në sektorë të tjerë të lidhur me atë të ujit).

Veprimet e ndërmarra për përafrimin e përgjithshëm të DKU-së janë përkthyer në “ndërhyrje” të identifikuar. Prandaj, “ndërhyrjet” në tekstin dhe tabelat e mëposhtme i referohen masave, veprimtarive dhe projekteve. Ndërhyrjet e mëtejshme (përveç atyre që janë në proces apo që janë planifikuar tashmë) që nevojiten për arritjen e përafrimit të plotë me DKU-në janë paraqitur në Tabelën e mëposhtme. Në përcaktimin e fazave të veprimeve të kërkuara për zbatimin dhe implementimin e DKU-së, qasja e ndërmarrë merret me specifikimin e viteve relative (duke filluar nga viti 0)¹².

Kriteret për përzgjedhjen e ndërhyrjeve u mbështetën në modelin e thjeshtë të mëposhtëm i cili shpreh rendin logjik të zbatimit të DKU-së së BE-së:

- Sigurimi i burimeve njerëzore,
- Përgatitja e politikës dhe dokumenteve të investimeve,
- Ndërtimi i sistemeve mbështetëse, dhe
- Investimet në infrastrukturën bazë¹³.

Të gjitha ndërhyrjet e propozuara janë ndarë në katër grupe kryesore:

¹² Asnjë supozim nuk është bërë në lidhje me kohën e fillimit të zbatimit. Supozimi i nënkuptuar është, rrjedhimisht, që sapo zbatimi të fillojë, një direktivë duhet të vihet në zbatim sa më shpejt të jetë e mundur, duke pasur parasysh ndërvarësitë që ekzistojnë ndërmjet veprimeve dhe direktivave. Në praktikë, ritmi me të cilin zbatohen direktivat, varet nga disponueshmëria e burimeve të pamjaftueshme të tilla si ato njerëzore, ekspertiza, kapitali dhe buxhetet operative. Jo çdo gjë mund të arrihet menjëherë. Nuk është e mundur të planifikohet një program realist zbatimi derisa kërkesat e burimeve të të gjithë sektorëve mjedisorë të jenë vendosur pranë njëra-tjetrës dhe të jenë krahasuar me burimet e disponueshme totale të përlogaritura për sektorin e mjedisit.

¹³ Meqë DKU-ja shërben gjerësisht si kuadër për një numër të madh direktivash të tjera, kërkesat e investimeve për zbatimin e kësaj Direktive janë vlerësuar si pjesë e zbatimit të direktivave të tjera, të tilla si Direktiva për trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC), Direktiva për PKNI – në (08/1/EC) dhe Direktiva për Nitratet (91/676/EEC), dhe nuk janë paraqitur këtu.

1. Forcimi institucional;
2. Përmirësimi i baseneve ujore;
3. Monitorimi dhe analiza e cilësisë së ujit;
4. Analiza ekonomike, investimet, planifikimi dhe raportimi.

Tabela 7: Ndërhyrjet që nevojiten për arritjen e zbatimit

Ndërhyrja	Veprimtaritë dhe projektet	Institucioni përgjegjës	Viti i zbatimit (relativ)														
			0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1. Forcimi institucional;																	
Forcimi i Autoritetit Kompetent në nivelin kombëtar	Punësimi i personelit të ri. Trajnimi i personelit të MMPAU-së. Sigurimi i harduerëve dhe softuerëve për MMPAU-në.	MMPAU-ja															
Forcimi i Këshillave të Baseneve të Lumenjve	Punësimi i personelit shtesë: Specialist i Burimeve Ujore, Ekspert i Cilësisë së Ujit, Ekspert i Bazës së të Dhënave dhe i GIS-it në secilën prej KBL-ve. Trajnimi i personelit dhe sigurimi i harduerëve dhe softuerëve.	KBL-të															
Projekti i AT-së për mbështetjen e zbatimit të DKU-së	Sigurimi i trajnimit fillestar. Përcaktimi dhe rënia dakord për ndarjen e përgjegjësive ndërmjet agjencive, mekanizmave të bashkërendimit, strukturave të komunikimit. Përgatitja e manualeve dhe udhëzuesëve të procedurave. Mbështetja e KBL-ve me regjistrin e zonave të mbrojtura, shqyrtimi i karakteristikave, rishikimi i ndikimit të njeriut.	QQ-ja, MMPAU-ja, KBL-të															
Bashkërendimi ndërkombëtar për basenet e lumenjve ndërkufitarë	Basenet e lumenjve të Drinit, Vjosës dhe Semanit	QQ-ja, KBL-të															
2. Përmirësimi i administrimit të baseve të lumenjve;																	
Rishikimi i karakteristikave të baseneve të lumenjve	Masat për përditësimin e rishikimit të karakteristikave të baseneve të lumenjve në intervale 6 vjeçare si edhe rishikime të tjera.	KBL-të															
Vlerësimi i ndikimit të veprimtarisë së njeriut tek çdo basen lumi	Krijimi i bazës së të dhënave të Baseneve të Lumenjve (burimet ujore, përdorimet/përdoruesit e ujit, inventari i ndotësve, analiza e të dhënave, verifikimi, përfundimi). Mbledhja e të dhënave në nivelin e Baseneve të Lumenjve individualë	KBL-të															
Krijimi i regjistrit të zonave të mbrojtura në çdo basen lumi	Siç specifikohet në Direktivë, përfshirja e zonave të mbrojtura në bazë të legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e natyrës .	MMPAU-ja, KBL-të															
Përcaktimi i objektivave mjedisore	Karakterizimi i të gjitha llojeve të trupave ujorë. Përcaktimi i objektivave mjedisore që do të zbatohen në çdo basen lumi për të	KBL-të															

Përgatitja e PABL-ve	Përgatitja e PABL-ve. Konsultimi me publikun. Përcaktimi i masave shtesë ku është e nevojshme. Përgatitja e planeve të emergjencës për të reaguar ndaj incidenteve. Publikimi i planeve përfundimtare për administrimin e baseneve të lumenjve.	KBL-të															
Implementimi i programeve	Zbatimi i masave shtesë që nevojiten për të siguruar arritjen e objektivave në lidhje me trupat ujorë.	KBL-të, AK-te															
Studimi për tarifin dhe rikuperimin e kostove	Zhvillimi i politikave për caktimin e çmimit të ujit të cilat nxisin përdorimin efikas të ujit, duke marrë parasysh PPP-të.	MMPAU-ja, ËSRE															
Raportimi para Komisionit	Rrethet e baseneve të lumenjve, duke përfshirë ujërat nëntokësore dhe ato bregdetare, autoritetet kompetente, planet për administrimin e baseneve të lumenjve, programet dhe planet që merren me nën-basenet, çështje të veçanta të ujit apo kategori dhe ekosisteme të veçanta të ujit, planet që mbulojnë pjesë të baseneve të lumenjve ndërkombëtarë.	MMPAU-ja															

Forcimi Institucional

Detyra e vënies në efektivitet të gjashtë Këshillave të Baseneve të Lumenjve për zbatimin e kërkesave të Direktivës është e një rëndësie shumë të madhe. Të gjithë aktorët institucionalë duhet të bien dakord dhe të jenë të qartë në lidhje me ndarjen e përgjegjësiave mes tyre.

Duhet krijuar një strukturë e qëndrueshme institucionale për monitorimin, zbatimin dhe raportimin. Ngritja dhe fuqizimi i institucioneve për administrimin e përbashkët të burimeve të ujërave ndërkufitare gjithashtu duhet të përfshihet në forcimin institucional.

Në kuadrin e forcimit institucional, janë parashikuar katër lloje veprimtarish:

- **Forcimi i numrit të personelit (dhe sigurimi i pajisjeve të nevojshme të zyrave)**

Kjo i adresohet jo vetëm Këshillave të Baseneve të Lumenjve, por gjithashtu edhe departamentit përkatës brenda MPPAU-së. Parashikohet që secili prej gjashtë KBL-ve do të forcohet nga marrja në punë e tre personave të tjerë (një specialist për burimet ujore, një ekspert për cilësinë e ujit dhe një ekspert për GIS/bazën e të dhënave). Gjithashtu, tre anëtarë të rinj të personelit (një specialist për burimet ujore dhe dy specialistë për cilësinë e ujit) do të punësohen në MMPAU.

- **Sigurimi i pajisjeve të nevojshme harduerë dhe softuerë për kryerjen e punës së tyre dhe raportimin;**

Kjo përfshin workstations/ serverat, rrjetet lokale të zonës, printera bardhë e zi dhe me ngjyra, skanera, plotera (të gjithë me kapacitet A3), softuerë të bazës së të dhënave, softuerë GIS, GPS etj, d.m.th. pajisjet e duhura për hartimin dhe paraqitjen e hartave dixhitale të rretheve të baseneve të lumenjve.

- **Projekti për asistencën teknike në lidhje me forcimin institucional**

Qëllimi i këtij projekti të AT-së do të jetë mbështetja e autoriteteve shqiptare në krijimin e një kuadri të shëndoshë për zbatimin e DKU-së. Përfituesit e projektit do të përfshijnë aktorët kryesorë që preken nga ndryshimet dhe të përfshirë në zbatimin e Direktivës, veçanërisht MMPAU dhe gjashtë KBU-ve.¹⁴ Veprimtaritë kryesore do të jenë:

1. Sigurimi i trajnimit fillestar (p.sh. në lidhje me ekonominë, trysnitë dhe ndikimet, trupat ujorë të modifikuar në masë të madhe, ndërkalibrimin, monitorimin, pjesëmarrjen e publikut, GIS-in, ujërat tokësore të kushteve të referencës,

¹⁴ Asnjë ndryshim nuk bëhet këtu ndërmjet Këshillave të Baseneve të Lumenjve dhe Agjencive të Baseneve të Lumenjve. Këto të fundit konsiderohen si pjesë përbërëse e të parave

- , procesin e planifikimit, ligatinat, klasifikimin e statusit ekologjik, ujërat nëntokësore).
2. Përcaktimi dhe pajtimi me ndarjen e saktë të përgjegjësive dhe detyrave ndërmjet agjencive të ndryshme. Përcaktimi dhe pajtimi me mekanizmat e bashkërendimit dhe strukturat e komunikimit ndërmjet agjencive.
 3. Hartimi i manualeve të procedurave dhe udhëzimeve për zyrtarët.
 4. Mbështetja e KBU-ve në kryerjen e detyrave të tyre fillestare:
 - a. Krijimi i regjistrit të zonave të mbrojtura;
 - b. Analiza e karakteristikave të trupave ujorë;
 - c. Rishikimi i ndikimit të veprimtarisë së njeriut;
 - d. Kriteret për vlerësimin e gjendjes së ujërave nëntokësore;
 5. Trajnimi gjatë punës.
- **Krijimi i bashkërendimit ndërkombëtar për basenet e lumenjve ndërkufitarë**
 Tre nga gjashtë rrethet e caktuara të baseneve të lumenjve në Shqipëri janë ndërkufitare, d.m.th. ai i Drinit-Bunës (me Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe më Malin e Zi , ai i Semanit (me Greqinë) dhe ai i Vjosës (me Greqinë). Për momentin, Greqia është i vetmi Vend Anëtar ndërmjet këtyre, por ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është Vend Kandidat dhe Mali i Zi dhe Kosova (në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit) janë Vende Kandidate potenciale. Neni 3 (paragrafët 3-5) parashikojnë bashkërendimin me Vende të tjera Anëtare të BE-së si edhe me palë të treta shtetesh për basenet e lumenjve ndërkufitarë. Bashkërendimi do të marrë formën e diskutimeve me këto vende në lidhje me modalitetet e bashkëpunimit, si edhe pjesëmarrjes në takime të platformave të krijuara ndërkombëtare.

Përmirësimi i administrimit të baseneve të lumenjve

Përmirësimi i administrimit të baseneve të lumenjve përfshin katër komponentë kryesorë:

- **Rishikimin e karakteristikave të baseneve të lumenjve .**
 Çdo KBL do të hartojë inventarin e të dhënave ekzistuese- të mbledhë të dhëna të tjera të nevojshme, të krijojë një bazë të dhënash të integruar të burimeve ujore dhe të lidhet në bazën e të dhënave GIS. Kjo do të përfshijë të dhënat e monitorimit, hartat, lejet, përdorimin e tokës, dheun, gjeologjinë, hidrogeologjinë, trupat ujorë, të dhënat ekzistuese dhe ato historike për cilësinë dhe sasinë e ujit , përdorimin e ujit, koncesionet, ujin mineral, hidrocentralet, ujitjen etj. Baza e të dhënave do të jetë plotësisht e gjeo-referuar dhe do të shërbejë si input për GIS-in.

- **Vlerësimi i ndikimit nga veprimtaritë e njeriut brenda baseneve të lumenjve.**
- **Krijimi i një regjistri të zonave të mbrojtura brenda baseneve të lumenjve.**
- **Përcaktimi dhe zbatimi i objektivave mjedisore për t'u aplikuar brenda basenit të lumit.**

Duhet krijuar një bazë të dhënash e integruar për ujërat nëntokësore për të gjitha të dhënat e mbledhura dhe të lidhet me një sistem GSI për të bërë të mundur paraqitjen e tyre. Gjithashtu duhet të bëhet edhe vlerësimi i gjendjes sasiore dhe cilësore të ujërave nëntokësore, dhe duhet të përcaktohet nëse përdorimi i burimeve të ujërave nëntokësore është i qëndrueshëm dhe nëse ka ndotje ekzistuese apo kërcënime të ndotjes së shkaktuar nga veprimtaria e njeriut. Duhet realizuar monitorimi periodik i burimeve të ujërave nëntokësore për të mundësuar ndjekjen e zhvillimeve të ardhshme nga pikëpamja sasiore dhe cilësore.

Karakteristikat e çdo baseni lumi duhet të shqyrtohen duke përdorur metodat e njohura nga BE-ja. Duhet të bëhet inventari i burimeve ujore, përdoruesve të ujit, përdorimeve të ujit, ndotësve potencialë, shkarkimeve dhe substancave të rrezikshme brenda çdo baseni lumi dhe pastaj të futet në bazën e të dhënave të basenit të lumit. Duhet të bëhet gjithashtu vlerësimi i ndikimit të veprimtarisë së njeriut mbi ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Duke u bazuar në gjendjen aktuale të basenit të lumit, do të bëhet karakterizimi i të gjithë trupave ujorë (fizik, kimik, biologjik, hidro-morfologjik, etj) si edhe i objektivave mjedisore që do të zbatohen për çdo basen lumi , të përcaktuara me synimin e arritjes së një cilësie sa më të mirë të ujit.

Mbështetja për disa prej këtyre veprimtarive do të sigurohet nga projekti për AT të cilit iu referuam në çështjen “Forcimi Institucional” më sipër.

Monitorimi dhe analiza e cilësisë së ujit

Për përcaktimin e cilësisë së ujit brenda baseneve të lumenjve duhet ndërtuar një skemë monitorimi (duke përfshirë vendndodhjet e monitorimit, parametrat e monitorimit dhe frekuencat e marrjes së kampionëve), duke përdorur metodat e akredituara të monitorimit dhe skemat e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu duhet të bëhet rekrutimi i personelit të nevojshëm për monitorimin. Monitorimi do të përfshijë parametrat e përzgjedhur kimikë dhe biologjikë për ujërat sipërfaqësore, ndërkohë që monitorimi i ujërave nëntokësore do të përfshijë përveç të tjerave edhe nivelet e ujërave për përcaktimin e gjendjes sasiore. Laboratorët e përzgjedhur duhet të akreditohen për të kryer analizat e cilësisë së ujit. Duhet të krijohet një bazë të dhënash për përpunimin e monitorimit dhe analizës së të dhënave

duke përfshirë këtu paraqitjen e të dhënave sipas formateve të kërkuara.

Duhet kryer analiza e bazuar në të dhënat e monitorimit për të përcaktuar statusin ekologjik të trupave ujqorë, si edhe nëse janë arritur objektivat e cilësisë mjedisore të baseneve të lumenjve. Ujqorët që për shkak të gjendjes së tyre natyrore nuk do të arrijnë një cilësi të mirë edhe pse janë marrë të gjitha masat e duhura për përmirësimin e tyre duhet të identifikohen, dhe po ashtu duhet të bëhet edhe identifikimi i trupave ujqorë specifikë për të cilët duhen vendosur objektiva mjedisore më pak rigorozë.

Për të arritur këtë, duhet të shfrytëzohen plotësisht rezultatet e ushtrimit të ndërkalibrimit për të siguruar përputhshmërinë me vende të tjera anëtare.

Është propozuar që Shqipëria duhet të kërkojë financime për një projekt AT-je i cili do të mbështeste zbatimin e veprimtarive të monitorimit. Ky projekt AT-je do të përfshijë veprimtaritë e mëposhtme:

1. projektimin e rrjetit të monitorimit të mbikëqyrjes: numrin dhe vendndodhjet e stacioneve të monitorimit, frekuencat e marrjes së kampionëve (të arsyeshme, me nivel besimi, saktësinë e pritur);
2. marrjen e masave për sigurimin dhe instalimin e pajisjeve të nevojshme shtesë (pajisjet ekzistuese do të përdoren kur është e mundur);
3. hartimi i udhëzimeve, procedurave e marrjes së kampionëve, analizës, sipas standarteve të përcaktuara në DKU;
4. përzgjedhja dhe trajnimi i laboratoreve të përshtatshme, prezantimi i procedurave të VC/KC-së, përgatitja për akreditimin;
5. trajnimi i personelit që do të kryejë monitorimin (formal dhe gjatë punës);
6. zhvillimi i kriterëve për vlerësimin e gjendjes së trupave të ujqorëve sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore (duke marrë parasysh ushtrimin e ndërkalibrimit);
7. mbështetjen e programeve të monitorimit të mbikëqyrjes (një vit) në gjashtë rrethet e përcaktuara të baseneve të lumenjve;
8. mbështetjen e projektimit të programit operativ të monitorimit në gjashtë rrethet e përcaktuara të baseneve të lumenjve;
9. mbështetjen e projektimit dhe realizimit të bazës së të dhënave dhe sistemeve të raportimit.

Analiza ekonomike, investimet, planifikimi dhe raportimi

Qëllimi i studimit ekonomik është (i) grumbullimi i të dhënave të kërkuara për kryerjen e veprimtarisë së rikuperimit të kostove të referuar në Nenin 9 të DKU-së dhe (ii) mundësimi i zgjedhjeve që duhen bërë në lidhje me masat më kosto-efektive në programin e masave të referuar në Nenin 11. Analiza ekonomike e përdorimit të ujit është çelësi për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të aftë për zbatimin e sistemit efikas të vendosjes së çmimeve dhe tarifave

në bazë të parimit “ndotësi dhe përdoruesi paguan”, si edhe të parimit të rikuperimit të plotë të kostove të shërbimeve.

Analiza ekonomike/studimet e realizueshmërisë të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve do të kërkohen për të bërë vlerësimin e nevojave për infrastrukturë. Analiza ekonomike duhet të përfshijë parashikimin e kërkesës për ujë, kostot e nxjerrjes dhe furnizimit të ujit, shkarkimin e ujërave të ndotura etj. Bashkëpunimi ndërmjet ekonomistëve, planifikuesve (rajonalë, bashkiakë etj), furnizuesve të ujit, organizatave industriale dhe aktorëve të tjerë mund të jetë i nevojshëm për të përfutur analizën e duhur.

Duhet të hartohet një program masash të detyrueshme, në bazë të të gjithë informacionit të mbledhur, për të arritur objektivat mjedisore për basenet ujore. Ky program duhet të përfshijë Planet për Administrimin e Baseneve të Lumenjve, ku futen masat për mbrojtjen e ujit, përdorimi efikas dhe i qëndrueshëm i ujit, plani financiar, sistemi i tarifave, procedurat e dhënies së lejeve, masat shtesë etj. Duhet të zhvillohet një mekanizëm i përshtatshëm konsultimi për të lehtësuar konsultimin me publikun në lidhje me planet e administrimit të baseneve të lumenjve, si edhe duhet krijuar formati për publikimin e planeve përfundimtare. Duhet zhvilluar planet shtesë specifike ashtu siç kërkohet si edhe duhet të përgatiten planet e emergjencës në rast incidentesh. Programi duhet të theksojë gjithashtu forcimin e shërbimeve të inspektimit duke përfshirë vendosjen e penaliteteve për mos-zbatimin e ligjit.

Duhet hartuar edhe plani për investimet dhe përcaktimin e prioriteteve për sektorin e ujit. Duhet vendosur kriteret për përcaktimin e prioriteteve të investimeve në fushën e mbrojtjes së ujit dhe duhet të prezantohet një sistem i huave qeveritare për investime në sektorin e ujit (furnizimi me ujë, rrjetet e ujërave të ndotura urbane, planet për trajtimin e ujërave të ndotura, masat e mbrojtjes etj.) Duke pasur parasysh kapacitetin e kufizuar financiar të vendit, dhe duke u bazuar tek analizat ekonomike, duhet të zhvillohen mekanizmat financiarë për përshpejtimin e investimeve në fushën e mbrojtjes mjedisore (të ujit). Kjo gjithashtu i referohet edhe zhvillimit të mekanizmave për zbatimin e sistemit të rikuperimit të plotë të kostove në këtë sektor.

Është propozuar që të kërkohen financime për një projekt AT-je, qëllimi i të cilit do të jetë mbështetja e autoriteteve kompetente shqiptare, dhe në veçanti këshillat e administrimit të baseneve të lumenjve, me planifikimin e tyre ekonomik dhe veprimtaritë e planifikimit të administrimit të baseneve të lumenjve. Prandaj ky projekt do të përfshijë:

- mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave ekonomike të parashikuara në Nenin 5(1), pika e tretë dhe Shtojcën III, veçanërisht të dhënat për kostot dhe investimet për sigurimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve, të dhënat në lidhje me shkarkimet nga burimet e ndryshme fikse dhe të shpërndara, qasjet për pakësimin e tyre si edhe për kostot dhe efektivitetin e tyre, të dhënat për koston e dëmit të shkaktuar nga përkeqësimi i gjendjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

- identifikimin e “çështjeve të rëndësishme të administrimit të ujërave” në basenet e lumenjve si pjesë e proceseve të planifikimit të ABL-ve;
- mbështetjen e KBL-ve në hartimin dhe rishikimin e planeve të administrimit të baseneve të lumenjve dhe propozimin e programeve të masave të nevojshme;
- mbështetjen e KBL-ve në hartimin e planeve për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe për të siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit të ABL-ve . Është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët- departamente të tjera përkatëse qeveritare, komunitetet vendore, shërbimi i ujësjellësit, industria dhe tregtia, konsumatorët, OJQ-të dhe grupet mjedisore- të marrin plotësisht pjesë në diskutimet në lidhje me planet e baseneve të lumenjve, meqë ka të ngjarë që këto të kenë ndikim tek të gjitha këto organizata, dhe të varen nga veprimet e ndërmarra nga organizatat e lartpërmendura në arritjen e objektivave të tyre. Në veçanti, autoritetet duhet të kenë në dispozicion burimet e duhura për të marrë në shqyrtim të gjitha pyetjet, mendimet dhe prezantimet e bëra para tyre, si edhe të programojnë publikimet , njoftimet dhe takimet e nevojshme publike.
- Mbështetjen e KBL-ve në sigurimin nëpërmjet tarifave, pagesave dhe penalteteve të rikuperimit të kostove, duke përfshirë kostot mjedisore dhe ato të burimeve, duke pasur parasysh analizën ekonomike të referuar më sipër dhe në përputhje me parimin ndotësi paguan.

E gjitha puna për planet e administrimit të baseneve të lumenjve duhet të bashkërendohet me punën për zbatimin e direktivave të tjera që lidhen me Direktivën në fjalë, veçanërisht Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane, Direktiva për PKNI –në dhe Direktiva për Nitratet, meqë këto të fundit do të kenë një ndikim të madh në gjendjen e ujit të baseneve të lumenjve.

Duhet ngritur një strukturë për raportimin para Komisionit, duke përdorur bazat e krijuara të të dhënave. Raportimi duhet të përfshijë detajet e emërimit të Autoritetit Kompetent, informacionin në lidhje me rrethet e baseneve të lumenjve, planet/ programet e veçanta, si edhe planet që mbulojnë pjesët e baseneve të lumenjve ndërkombëtarë.

Priten të identifikohen hapa dhe projekte konkrete në dokumentet strategjike (Strategjia për Ujin) dhe ata të planifikimit (Masterplani për Ujin dhe Planet për Administrimin e Baseneve të Lumenjve).

5 Kostot dhe përfitimet

Zbatimi i DKU-së do të krijojë kosto dhe përfitime si gjatë procesit të PABL-ve ashtu edhe nga programet e masave të identifikuar nëpërmjet këtij procesi. Është gati e pamundur që të bëhet përlogaritja e përafërt e kostove dhe e përfitimeve të programeve të masave në lidhje me informacionin aktual të tilla si kostot të cilat do të përcaktohen vetëm pas kryerjes së punës së përsëritur teknike dhe ekonomike që parashikon Direktiva. Në veçanti, kjo varet nga gjetjet e analizës së karakterizimit të baseneve të lumenjve, nga shkalla e rrezikut të dështimit për të arritur një gjendje të mirë, si edhe nga shkaqet e tyre, dhe për këtë arsye duhet bërë identifikimi i oposioneve të efektshme për përlogaritjen e kostove.

Prandaj për qëllimin e planit të zbatimit, kostot e paraqitura janë dhënë në terma tregues, duke pasqyruar pasigurinë në lidhje me cilat masa do të kërkohen me saktësi dhe cilat do të jenë kostot shoqëruese të tyre.

5.1 Burimet dhe kostot

Është bërë një përlogaritje e kostove të veprimeve të ndryshme që nevojiten për përafrimin dhe zbatimin e Direktivës në fjalë. Rezultatet e përcaktimit të këtyre kostove janë paraqitur më poshtë. Qasja e përdorur gjatë përcaktimit të kostove dhe disa nga supozimet e përgjithshme të bëra janë përshkruar në seksionet e mëposhtme.

Metoda e përlogaritjes së kostove dhe burimet e të dhënave të kostove

Pika fillestare ishte lista e ndërhyrjeve të paraqitura në Tabelën 4. Kjo listë u nda më tej në veprime dhe nën-veprime siç përshkruhet në Shtojcën II.

Kërkesat e burimeve për çdo veprim u vlerësuan nga ekspertët e projektit. Këto kërkesa përfshinin:

- Burimet njerëzore (burimet në përgjithësi mendohet të jenë burime të reja të cilat do të kërkohen në mënyrë të vazhdueshme),
- Kërkesat për trajnim,
- Pajisjet dhe materialet që duhet të sigurohen,
- Hartimi i dokumenteve të nevojshme, dhe

- Projektet/ ekspertët e asistencës teknike (burimi për projektet e asistencës teknike u bazuan tek preventivat, tek përvoja e shkuar, e imputeve të nevojshme të projektit të AT-së përta si përket konsulentëve ndërkombëtarë dhe vendas si edhe burimeve të tjera).

Gjatë përcaktimit të këtyre kostove, u bë supozimi i mëposhtëm:

- Direktiva parashikon përgatitjen e planeve për administrimin e baseneve të lumenjve të cilat përmbajnë programet e masave që nevojiten për arritjen e objektivave të Direktivës. Kostot e këtyre masave teknike mendohet se do të krijohen në bazë të direktivave të tjera. Programet e masave të nevojshme teknike për përmbushjen e Direktivës për PKNI-në (2008/1/EC) (masat për ujën), Direktivës për Ujërat e Ndotura Urbane (91/271/EEC) si edhe të pjesëve të tjerë të legjislacionit të BE-së do të kenë një ndikim shumë të madh në cilësinë dhe gjendjen e ujërave kombëtare, dhe duhet të përbëjnë prioritetin kryesor. Mendohet që nuk do të nevojiten masa shtesë (ashtu siç referohet në Shtojcën VI.B të Direktivës) për arritjen e objektivave të saj.

Kostot e transpozimit dhe të zbatimit janë trajtuar veçmas më poshtë.

Kostot e transpozimit

Direktiva Kuadër për Ujin është një pjesë mjaft komplekse e legjislacionit dhe do të kërkohej përpjekje shumë të mëdha për transpozimin e saj të plotë në legjislacionin e BE-së. Progresi i deritanishëm ka qenë mjaft modest. Çdo vit, bëhet vlerësimi i progresit të Shqipërisë në drejtim të transpozimit dhe zbatimit të elementëve kryesorë të legjislacionit të BE-së. Në vlerësimin më të fundit kryer nga QRM-ja¹⁵, e cila mori parasysh gjendjen e prillit 2008, u vlerësua se shkalla e transpozimit të DKU-së ishte 6%, me një përmirësim shumë të vogël në krahasim me vlerësimin e bërë gjatë vitit paraardhës (fundi i vitit 2007), me MMPAU-n e cila nuk ishte në gjendje të propozonte një datë të parashikuar për përfundimin e transpozimit. Përta si përket zbatimit, ai është ende në fazën fillestare.

Duke pasur parasysh burimet e kufizuara për hartimin e ligjeve brenda MMPAU-t, do të ishte mjaft e mirëpritur mbështetja që do t'i jepej skuadrës ligjore në përgatitjen e këtij legjislacioni. Një nga detyrat e nevojshme për transpozimin e elementeve të renditur në seksionin 4.3, d.m.th. detyra e fundit- përgatitja e VKM-së për Planet e Administrimit të Baseneve të Lumenjve në bazë të LBU-së që do të bëjë transpozimin e e dispozitave kryesore të 3 direktivave përta si përket përmbajtjes, përgatitjes dhe zbatimit të këtyre planeve- që do të ndërmerret nga ky projekt, por mbetet ende një vëllim shumë i

¹⁵ Qendra Rajonale Mjedisore:Raporti për Monitorimin e Progresit të Shqipërisë për vitin 2, në kuadrin e projekt- monitorimit të Progresit për Vendet Kandidate potenciale si edhe për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2007-2008, shtator 2008.

madh legjislacioni parësor dhe dytësor për t'u hartuar. Rekomandohet që do të ishte mjaft i nevojshëm fillimi i një projekti AT-je i përmasave mesatare (440 ditë konsulentë ndërkombëtarë, 440 ditë konsulentë vendas) i cili do të mundësonte transpozimin e plotë. Kjo do të integrohej edhe me projektin tjetër për AT-në në sektorin e ujit nëse kjo do të ishte e volitshme.

Mbi këtë bazë, kostot shtesë të transpozimit të plotë do të ishin be 800,000 Euro.

Kostot e zbatimit

Kostot e përlogaritura të zbatimit të Direktivës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8: Kostot e zbatimit të ndara sipas kategorisë së shpenzimeve

Lloji i kostos	Kostot Kapitale/ që bëhen vetëm një herë ¹⁶ (në mijë euro)	Kostot operative/pe riodike(në mijë euro/vit)	Vërejtje
Personel shtesë: 25 persona		294	Në MMPAU dhe KBL-të. Përfshijnë kostot sociale dhe ato që lidhen me punësimin: hapësira e zyrave, ngrohja, pajisjet normale, raportimi, kostot e përgjithshme. Gjithashtu përfshihen edhe dietat e personelit për monitorimin në terren.
Asistenca teknike	4,800		Tre projekte të veçanta AT-je të lejuara
Softuerë, harduerë, (GIS) pajisje	201	10	5% për O&M
Konsultimi me publikun	120		Duke pasur parasysh planet për administrimin e baseneve të lumejnve

¹⁶ Të gjitha kostot janë përlogaritur me çmimet konstante të vitit 2008

Pajisjet e monitorimit	312	15	Blerja dhe instalimi i instrumenteve të nevojshëm
Automjetet	30	10	1 automjet 4x4 për punën në terren, plus karburantin, riparimet dhe mirëmbajtjen
Analiza (kimike, fizike, biologjike)		135	Kostot në bazë të tarifave të përlllogaritura të laboratorit, dhe jo kostot e laboreve
Raportimi në Komisionin Evropian		30	Buxheti që do të mbulojë kostot shtesë për hartimin e raporteve
Bashkërendimi ndërkombëtar		30	Shpenzimet e udhëtimit dhe dietat për pjesëmarrjen në takime ndërkombëtare
Totali	5,433	524	

Kostot totale të zbatimit përbëhen nga kostot kapitale prej 5.4 milion Eurosh si edhe kostot operative(periodike) në vlerën prej 524,000 Euro në vit. Këto kosto, në rradhë të parë do të përballohen nga autoriteti kompetent kombëtar i cili ka përgjegjësinë e zbatimit të Direktivës si edhe nga autoritetet e reja të baseneve të lumenjve.

Kostot totale kanë të bëjnë kryesisht me krijimin e infrastrukturës së duhur administrative dhe ndërtimin e kapacitetit të saj, si edhe me ngritjen dhe vënien në efektivitet të sistemit të monitorimit, dhe jo me kostot e masave teknike. Këto të fundit mendohet të ndërmerren në kuadër të Direktivave të tjera.

Është vlerësuar se duhet një total prej 25 personash të tjerë, me një kosto prej 294,000 Euro në vit: 3 persona brenda autoritetit kompetent(MMPAU), 3 persona me kohë të plotë pune për të mbështetur secilin nga gjashtë autoritetet e baseneve të lumenjve, dhe 4 persona për veprimtarinë e monitorimit.

Kostot totale të përlllogaritura për projektet e asistencës teknike , mbi 4.8 milion Euro, pasqyrojnë fushën ambicioze të zbatimit të kësaj Direktive.

Kosto të tjera kanë të bëjnë me kostot e përmirësimit të rrjetit të monitorimit dhe zhvillimit të programeve të nevojshme të monitorimit, kostot e sigurimit dhe/ose përmirësimit të harduerëve dhe softuerëve të nevojshme për krijimin e sistemeve GIS dhe bazës së të dhënave, kostot e konsultimit me publikun në lidhje me planet e administrimit të baseneve të lumenjve, kostot e raportimit para Komisionit Evropian si edhe kostot e konsulentëve ndërkombëtarë.

Kostot shitesë aktuale

Përcaktimi i mësipërm i kostove përfshiu identifikimin e të gjitha funksioneve të reja që kërkohen për transpozimin dhe zbatimin e DKU-së. Sidoqoftë, funksionet e reja nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht kosto shtesë. Le të marrim rekrutimin e personelit për shembull. Sipas rekomandimeve të FMN-së, Shqipëria po bën përpjekje për reduktimin e numrit të nëpunësve civilë me rreth 10%. Qeveria shqiptare dhe MMPAU nuk ka të ngjarë që ta mirëpresin propozimin për një numër më të madh të nëpunësve civilë për zbatimin e legjislacionit mjedisor të BE-së, edhe pse kjo mund të jetë një domosdoshmëri për funksionet e reja, apo mund të argumentohet që shtimi i përpjekjeve që kërkohen për zbatimin e legjislacionit të BE-së është në mënyrë proporcionale më i madh për mjedisin në krahasim me sektorët e tjerë. Kjo do të thotë që ose nëpunësit e rinj do të duhet të rekrutohen nga rradhët e nëpunësve ekzistues të shërbimit civil, (pa i zëvendësuar këta të fundit), ose që vendet e reja të punës do të plotësohen nga shkurtime apo mbylljet e vendeve të punës në sektorë të tjerë të shërbimit civil. Nëse qeveria, apo MMPAU, kanë sukses në krijimin e këtyre funksioneve të reja pa shtuar numrin total të listëpagesave, mund të argumentohet që kostot shtesë që kanë të bëjnë me pagat janë zero. Por vështirësitë e rekrutimit të kandidatëve të përshtatshëm nga funksione të tjera (të panevojshme apo të domosdoshme), ose të arritjes së reduktimit të pagave diku tjetër nuk do të nënvlerësohen, dhe kjo do të thotë që norma e zbatimit nuk mund të jetë shumë e shpejtë.

E njëjta gjë ndodh edhe me monitorimin mjedisor: më sipër është përlogaritur mesatarisht që kostot operative (duke përfshirë edhe kostot kapitale) të monitorimit që kërkohen për përmbushjen e DKU-së do të jenë 182,000 Euro në vit. Por shpërndarja e tanishme në buxhetin e MMPAU-t për monitorimin (që mbulon gjithashtu vetëm kostot operative) është 110,000 Euro në vit, prej të cilave një e treta, 37,000 Euro në vit, janë për ujin. Mbi këtë bazë, kostot operative shtesë për monitorimin e ujit do të ishin vetëm 145,000 Euro në vit.

5.2 Strategjia e Financimit

Në fillim duhet bërë dallimi ndërmjet kostove kapitale (që bëhen vetëm njëherë) dhe tyre operative (periodike).

5.2.1 Kostot kapitale (që bëhen vetëm njëherë)

Duke pasur parasysh që shpenzimet qeveritare ka të ngjarë që të kufizohen në vitet e ardhshme, qeveria duhet të kërkojë të sigurojë marjen e fondeve në masën më maksimale të mundshme për të mbuluar kostot kapitale (që bëhen vetëm njëherë) dhe ato të investimit që shoqërojnë transpozimin e Direktivës në legjislacionin kombnëtar dhe zbatimin e saj. Sigurisht që kjo përfshin jo vetëm projektet për asistencë teknike dhe trajnime, por gjithashtu për shembull edhe sigurimin e mëtejshëm të pajisjeve, softuerëve dhe të dhënave të nevojshme për monitorimin, përpunimin e të dhënave

dhe për sistemin GIS. Këto artikuj mund të lindë nevoja që të përfshihen në projektet e AT-së për të siguruar që financimi i grantit të dëshiruar do të realizohet. Kjo është e lejueshme normalisht për sa kohë që mbizotërojnë kostot e lementëve të AT-së, që në fakt kështu do të jetë, meqë përmbajtja e pajisjeve dhe harduerëve në total është më pak se 15%.

Mbi këtë bazë, financimi total i granteve që nevojiten do të jetë mbi 6.2 milion Euro, pjesa më e madhe e tij, sipas supozimeve të bëra, në tre apo katër vitet e para.

Financimi i granteve të BE-së për projektet e asistencës teknike në sektorin e ujit do të kanalizohet nëpërmjet “Instrumentit të Asistencës Para-aderimit” (IPA) dhe financimi do të realizohet edhe nga donatorë dypalësh. Kjo është përshkruar shkurtimisht më poshtë.

Instrumenti për Asistencën Para-aderimit (IPA)

IPA u prezantua në janar 2007, duke zëvendësuar programet dhe instrumentet financiare të ndryshme të mëparshme të BE-së për vendet candidate dhe ato potenciale, të tilla si PHARE, ISPA, SAPARD dhe CARDS.

IPA përbëhet nga pesë komponentë të ndryshëm:

- I. Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin e institucioneve;
- II. Bashkëpunimi ndërkufitar (me Vendet Anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera të mundshme për IPA-n);
- III. Zhvillimi rajonal (zhvillimi i transportit, mjedisit dhe ai ekonomik);
- IV. Burimet njerëzore (forcimi i kapitalit njerëzor dhe lufta kundër përjashtimit);
- V. Zhvillimi rural.

Komponenti I përfshihet në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerimin të Komisionit, e cila është gjithashtu përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm të asistencës së para-aderimit. Ai përfshin masat për ndërtimin e institucioneve dhe investimet shoqëruese, si edhe masat për tranzicionin dhe stabilizimin atje ku është e nevojshme. Ai realizohet nëpërmjet programeve vjetore kombëtare dhe shumë përfituesve.

Komponenti II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar në kufijtë ndërmjet vendeve candidate/ potencialisht candidate si edhe ndërmjet tyre dhe vendeve të BE-së. Drejtorja e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Drejtorja e Përgjithshme për Zhvillimin Rajonal të Komisionit janë bashkërisht përgjegjëse për zbatimin e komponentit II. Kërkohej gjithashtu një zbatim i përbashkët me vendet fqinje.

‘Vendet potencialisht candidate’ të tilla si Shqipëria kanë të drejtë të përfitojnë vetëm nga komponentët I dhe II të përshkruar më sipër.

BE-ja bën shpërndarjen shumëvjeçare të fondeve në bazë të Kuadrit Financiar Shumëvjeçar të IPA-s(Maff). Shifrat për Shqipërinë janë si më poshtë :

Viti	komponent i I (në milion euro)	komponenti II (në milion euro)	Totali (në milion Euro)
2007	54.3	6.7	61.0
2008	61.1	9.6	70.7
2009	70.9	10.3	81.2
2010	82.7	10.5	92.3
2011	?	?	98.7

Shumat e disponueshme në të ardhmen ka të ngjarë që të rriten realisht ngadalë pas vitit 2011 deri në datën e aderimit. Kur Shqipëria të bëhet plotësisht një vend kandidat, gjithashtu do të ketë një rritje edhe të shpërndarjes treguese të fondeve.

Sigurisht që këto shuma mbulojnë ndihmën në të gjithë sektorët, jo vetëm në ata mjedisorë apo të ujit. Projektet klasifikohen sipas detyrimeve politike, ekonomike dhe të anëtarësimit. Ndarja ndërmjet këtyre grupeve në shpërndarjen e fondeve për vitet e periudhës 2007-2009 ishte përkatësisht 30-35%, 20-25% dhe 40-50% . Asistenca për zbatimin e Direktivës Kuadër për Ujin do të klasifikohet si një detyrim për anëtarësimin. Grantet e dhëna deri më sot në kuadrin e IPA-s përfshijnë financimin me grante në shumën 24 milion Euro për të mbështetur ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve në Shkodër, Velipojë, Shëngjin dhe Golem-Kavajë.

Por duhet shënuar që akordimi i fondeve të vitit 2007 po pret aktualisht miratimin përfundimtar të BE-së, miratimi për ato të vitit 2008 është pak më i vonuar, dhe shpërndarja e fondeve për vitin 2009 ende është në fazën e programimit. Projektet e reja nuk do të mundësohen para IPA 2010, që nuk do të fillojë akordimin e fondeve para vitit 2011.

Kur Shqipëria më në fund të futet në BE , ajo do të jetë në gjendje të aplikojë për financim nga Zhvillimi Rajonal dhe Fondet e Kohezionit. Për momentin nuk dihet se sa do të jetë masa e financimit të disponueshëm, por në bazë të përvojës së vendeve që u futën në BE në vitin 2004 si edhe të Rumanisë dhe Bullgarisë, ka të ngjarë që shuma të cilat i tejkalojnë në mënyrë të konsiderueshme fondet e dhëna për para-aderimin të vihen në dispozicion të Shqipërisë për të ndihmuar zhvillimin e infrastrukturës së saj në nivelin e standarteve të BE-së.

Duke filluar me akordimin e fondeve të IPA 2008, pritet që Shqipëria të sigurojë bashkëfinancim- nga 10% për projektet e AT-së deri në 25% për ato të investimeve. Sidoqoftë, në rastin e parë, ky bashkëfinancim mund të jetë “në natyrë” dhe jo domosdoshmërisht në formën e një kontributi monetar. Meqë kjo mund të përfshijë pagat e homologëve pjesëmarrës të shërbimeve publike, dhe meqë kjo pjesëmarrje është në çdo rast e mirëpritur dhe me të vërtetë e nevojshme për një projekt AT-je, kostot e bashkëfinancimit nga ana e Shqipërisë mendohet të jenë zero.

Ndihma të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Sipas bazës së të dhënave të projekteve të ndihmës që mirëmbahen nga njësia e bashkërendimit të donatorëve të huaj brenda Këshillit të Ministrave, donatorët jo nga BE-ja, morën përsipër rreth 2600 milion Euro ndihma gjatë viteve 2000- 2008. Kjo ndihmë arriti kulmin në rreth 470 milion Euro në vitin 2005, dhe më pas ra gradualisht. Nga ky total, rreth 280 milion Euro ishin në mënyrë specifike për projektet e sektorit të ujit (kryesisht për ujësjellësat dhe kanalizimet), nga të cilat 100 milion Euro ishin grante dhe 180 milion të tjera si hua, dhe më tej shuma prej 86 milion Eurosh (e akorduar gjatë katër viteve të fundit, nga të cilat 65 milion ishin në formën e granteve) shkoi për projekte të tjera në sektorin mjedisor. Qeveritë dhe institucionet kryesore donatore gjatë kësaj periudhe ishin BE-ja, Gjermania, Italia, Austria dhe Holanda. Qeveria duhet të përpiqet të sigurojë që sa më shumë ndihmë të jetë e mundur të jepet në drejtim të asistimit të Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve të saj të aderimit në BE.

5.2.2 Kostot operative (periodike)

Kostot operative (periodike) që arrijnë shumën prej rreth 524.000 Euro në vit nuk kualifikohen për ndihmë në formën e granteve, dhe duhet që të mbulohen nga buxheti i shtetit. Sidoqoftë, siç u theksua më sipër, ka tension ndërmjet nevojave të dukshme buxhetore që kanë të bëjnë me sigurimin e funksioneve të reja që lindin si pasojë e dispozitave të legjislacionit evropian dhe përpjekjeve për të përmirësuar dhe bërë më të efektshëm shërbimin civil si edhe për të reduktuar numrin e nëpunësve të tij. Për shembull, shuma e hequr mënjane për pagat në buxhetin kombëtar afatmesëm për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vetëm për dy drejtoritë e Planifikimit, Menaxhimit dhe administrimit në buxhetet tregues për periudhën 2009-2011 në krahasim me buxhetin e vitit 2008 është si më poshtë:

Shumat e parashikuara në buxhetin kombëtar afatmesëm për rritjet e pagave për tre vitet e ardhshme në dy drejtoritë mjedisore të MMPAU-t.¹⁷

¹⁷ Këto dy drejtori u përfshinë vetëm meqë ato janë departamentet që korrespondojnë më shumë me kreun mjedisor të BE-së

	Buxheti	Parashikimi në Buxhetin Afatmesëm 2009-2011 për pagat ('000 lek)		
		2009	2010	2011
Planifikimi, menaxhimi dhe Administrimi	54,000	52,100	53,500	55,000
Administrimi i Ujërave	18,000	18,500	19,000	20,000
	72,000	70,600	72,500	75,000
Rritja vjetore (%)		-1.9%	2.7%	3.4%

Burimi: MMPAU

Siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, buxheti për pagat reduktohet nga 2008-2009, dhe rritjet gjatë periudhave 2009-2010 dhe 2010-2011 zor se kanë të njëjtin ritëm me inflacionin.

Qëllimi i këtij dokumenti është sigurisht vetëm të bëjë identifikimin e kërkesave për burimet e nevojshme për zbatimin e Direktivës Kuadër për Ujin, dhe jo të japë shpjegime të sakta përputhen me synimin e Shqipërisë për rritjen e efektshmërisë së shërbimit të saj civil.

5.3 Përfitimet

Përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i DKU-së ndahen në dy komponentë:

1. përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit ujqor nga ndotja, dhe
2. Përfitimi informues dhe administrativ nga shtimi i monitorimit dhe planifikimit gjithëpërfshirës.

Përfitimet nga përmirësimi ekologjik

Përmirësimi ekologjik i mjedisit ujqor do të çojë në lumenj, liqene, dhe ujëra bregdetare dhe grykëderdhje lumenjsh më të pastër dhe të shëndetshëm, duke siguruar kushte më të mira jetese për botën ujore si edhe për kafshët dhe shpendët e tokës.

Një gamë e gjerë përfitimesh mund të vijne nga përmirësimi ekologjik:

- Përfitime të përgjithshme argëtuese (vizitat dhe përdorimi i brigjeve të lumenjve dhe i bregdetit) për shëtitje, soditjen e kafshëve të egra, piknikë etj si edhe për ata që jetojnë pranë trupave ujorë.
- Përfitime nga personat që merren me sporte ujore të tilla noti, lundrimi me canoe, sërfi etj si edhe me veprimtari që kanë lidhje me to.
- Përfitime për përdoruesë të tjerë të trupave ujore të tilla si industria dhe bujqësia që mund të shohin një cilësi më të mirë dhe/ose disponueshmërinë e ofertave.
- Përfitime që nuk varen nga përdorimi, që rrjedhin nga vlerat që shoqërojnë administrimin e mirë të mjedisit për brezat e ardhshëm ose nga vlerat e brendshme të mjedisve mbështetëse.

Përfitimet administrative, monitorimit dhe planifikimit

Mbulimi i gjerë i DKU-së do të siguronte një qasje më të integruar për planifikimin e baseneve të lumenjve. Do të arrihej një nivel i lartë bashkërendimi dhe komunikimi që do të siguronte një politikëbërje plotësisht të informuar. Kërkesat për konsultime ka të ngjarë që të gjenerojnë ide të reja dhe të vënë në dispozicion informacione të reja në lidhje me mjedisin lokal, duke siguruar kështu zbatimin e masave të duhura si edhe marrjen e avantazheve nga sinergjitë.

Përfitimet nga administrimi, monitorimi dhe planifikimi mund të përfshijnë:

- Përfitimet nga administrimi koherent i baseneve të lumenjve , të cilat do të mundësojnë zhvillimin e strategjive më kosto-efektive nëpërmjet prodhimit të PABL-ve të bashkërenduara, si edhe njohjen e lidhjeve ndërmjet të gjitha ujërave në një basen lumi.
- Shmangien e kostove përmes planifikimit më të mirë të masave për mbrojtjen e ujit, që rezultojnë nga informacioni i siguruar në sajë të analizës së çdo baseni lumi.
- Avantazhet e përfituara nga caktimi i objektivave mjedisore dhe prezantimi i strategjive të përshtatshme mjedisore në bazë të rrethanave kombëtare dhe lokale. Kjo do të thotë që burimet mund të planifikohen për problemet që përbëjnë shqetësim të vërtetë.

ANNEX I: Table of Concordance

Directive 2000/60/EC Water Framework Directive including:

- Decision No 2455/2001/EC Establishing the list of priority substances
- Directive 2006/118/EC on the protection of groundwater against pollution and deterioration, and
- Directive 2007/60/EC on the assessment and management of flood risks

The main piece of Albanian legislation is the Law 8903 on Water Resources of 21-3-1996, as amended by Law 8375 of 15-7-1998, Law 8605 of 20-4-2000, and Law 8736 of 01-2-2001.

This ToC also takes into account the proposed changes to Law 8903 as prepared by the ELPA project.

Other relevant legislation includes:

- Law No. 8102 dated 28.3.1996 'On the Regulatory Framework for Water Supply and Waste Water Management' (as amended);
- Law No. No. 8515 dated 30.7.1999 'On Irrigation and Drainage';
- Law No. 9115 dated 24.7.2003 'On the Environmental Treatment of Polluted Waters';
- Law No. 8905 dated 6.6.2002 'On Protection of the Marine Environment from Pollution and Damage';
- Law No. 9103 dated 10.7.2003 'On the Protection of Transboundary Lakes';
- Law No. 8681 dated 2.11.2000 'On the Design, Construction and Maintenance of Dams and Tailings Dams'
- Law No 8934 dated 5.9.2002 On Environmental Protection, as amended by Law 9890 of 20.3.2008

None of the substantive provisions that are introduced by the WFD have been transposed. The detail that is required to be included in RBMPs is lacking, as are the Article 4 environmental objectives, Article 11 programme of measures, etc.

The substantive provisions of the Groundwater Directive and the Floods Risk Directive have likewise not been transposed.

Assuming that the Draft Law on Water Resources, as prepared by the ELPA project, is adopted, the substantive provisions of the Directives can be transposed (by this project) by way of DCM on River Basin Management Plans

Article	EU Obligation	National legislation (including draft legislation) (give text of relevant law or regulation & no. of article) ¹⁸	Corresponds/does not correspond/is lacking/is in conflict	Identification of changes needed in Albanian law	Responsible institution(s)	Recommendation for transposition
Art. 1	[Purpose]					
Art. 2	Definitions:	Draft Law on Water Resources (Draft LWR) Art 2.1b	corresponds			Draft LWR be adopted
	1. "Surface water"					
	2. "Groundwater"	Draft LWR Art 2.1a	corresponds			Draft LWR be adopted
	3. "Inland water"	Draft LWR Art 2.1c	corresponds			Draft LWR be adopted
	4. "River"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	5. "Lake"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	6. "Transitional waters"	Draft LWR Art 2.1c	corresponds			Draft LWR be adopted
	7. "Coastal water"	Draft LWR Art 2.1d	corresponds			Draft LWR be adopted
	8. "Artificial water body"	Draft LWR Art 2.1dh	corresponds			Draft LWR be adopted
	9. "Heavily modified water body"	Draft LWR Art 2.1e	corresponds			Draft LWR be adopted
	10. "Body of surface water"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	11. "Aquifer"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	12. "Body of groundwater"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	13. "River basin"	LWR Art 2.6 – referred to as 'water drainage basin'	corresponds			
	14. "Sub-basin"		lacking	Include definition in draft LWR		Draft LWR be adopted
	15. "River Basin District"	Draft LWR Art 2.6a	corresponds			Draft LWR be adopted
	16. "Competent Authority"					
	17. "Surface water status"	Draft LWR Art 26B.2	corresponds			
	18. "Good surface water status"	Draft LWR Art 26B.2 & 3	Corresponds in part	Include in draft Decision on RBMPs		Draft Decision on RBMPs
	19. "Groundwater status"	Draft LWR Art 26B.2	corresponds			
	20. "Good groundwater status"	Draft LWR Art 26B.2 & 3	Corresponds in part	Include in draft Decision on RBMPs		Draft Decision on RBMPs
	21. "Ecological status"	Draft LWR Art 26B.2	corresponds			
	22. "Good ecological status"	Draft LWR Art 26B.2 & 3	Corresponds in part	Include in draft Decision on RBMPs		Draft Decision on RBMPs
	23. "Good ecological potential"					
	24. "Good surface water chemical status"	Draft LWR Art 26B.2 & 3	Corresponds in part	Include in draft Decision on RBMPs		Draft Decision on RBMPs
	25. "Good groundwater chemical status"	Draft LWR Art 26B.2 & 3	Corresponds in part	Include in draft Decision on RBMPs		Draft Decision on RBMPs
	26. "Quantitative status"	Draft LWR Art 26B.2	corresponds			
	27. "Available groundwater resource"					

¹⁸ If draft legislation, please specify the status of the draft legislation.

Article	EU Obligation	National legislation (including draft legislation) (give text of relevant law or regulation & no. of article) ¹⁸	Corresponds/does not correspond in part/is lacking/is in conflict	Identification of changes needed in Albanian law	Responsible institution(s)	Recommendation for transposition
	28. "Good quantitative status"					
	29. "Hazardous substances"					
	30. "Priority substances"					
	31. "Pollutant"	Draft LWR Art 2.9a	corresponds			Draft LWR be adopted
	32. "Direct discharge to groundwater"					
	33. "Pollution"	Draft LWR Art 2.9	corresponds			Draft LWR be adopted
	34. "Environmental objectives"					
	35. "Environmental quality standard"	Draft LWR Art 2.13b	corresponds			Draft LWR be adopted
	36. "Combined approach"					
	37. "Water intended for human consumption"					
	38. "Water services"					
	39. "Water use"					
	40. "Emission limit values"	Draft LWR Art 2.13c	corresponds			Draft LWR be adopted
	41. "Emission controls"					
Art. 3.1	Coordination of administrative arrangements within River Basin Districts (RBDs). MS shall identify individual river basins lying within their national territory &, for Dir.'s purposes, shall assign them to individual RBDs.	LWR Art 6.1d	corresponds			
	[Small river basins may be combined with larger river basins or joined with neighbouring small basins to form individual RBDs where appropriate.]		lacking			Draft LWR
	Where ground waters do not fully follow a particular river basin, they shall be identified & assigned to the nearest or most appropriate RBD.		Lacking			Draft LWR
	Coastal waters shall be identified & assigned to the nearest or most appropriate RBD(s).		Lacking			Draft LWR
